# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7406 E enjte 11 Janar **2018** **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**



KORÇA BEER edhe sot më e mira ...


Dje në "Deutsche Welle"

Orest Çipa, 29 vjeç, është shef i Sektorit të Koordinimit të 24 Njësive Administrative që ka Bashkia e Tiranës, më e madhja në Shqipëri, me më shumë ... Vijon në faqen 20

Nga ANI RUCI

## Largimi i trurit, shkak ekonomia, siguria publike dhe institucionet e dobëta

Opinioni i Ditës

Nëse Shqipëria pret me padurim fillimin e funksionimit të reformës në drejtësi, pak orë më parë ka marrë një përgjigje jo aq pozitive. Për këtë ka ndihmuar ... Vijon në faqen 21

Nga BEN ANDONI

## Xhezair Zaganjori i vendos një gozhdë të fundit drejtësisë

Deputeti merr certifikatën e pastërtisë: Aplikova vullnetarisht

## Hapja e dosjeve, Romeo Gurakuqi: Si u zhdukën brenda 1 viti

"Dera e Shqipërisë duhet të jetë e hapur për bijtë, nipërit e mbesat e Shqipërisë së persekutuar, që u nxorën jashtë me manifet nga viti 1991"

Nga VALENTINA MADANI

Disa deputetë të PD-së kanë aplikuar vullnetarisht për marrjen e certifikatës së pastërtisë së figurës, e cila vërteton se nuk kanë lidhje me ish-Sigurimin e Shtetit. Njëri prej tyre është deputeti i qarkut të Shkodrës, z.Romeo Gurakuqi... Në faqen 3

NIS SOT KOMPENSIMI, 1300 PRONARET QE DUHET TE PLOTESOJNE DOKUMENTET

# PRONAT, FORMULARI I RI PER KOMPENSIMIN

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, publikohet procedura për pagesat. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura

*(Në foto)* Zonë informale (foto ilustruese)

Në faqet 13-17

STUDIMI I ASHR-së

**Alarmi, 1 në 10 fëmijë hanë vetëm një vakt në ditë. Kamza, zona më e kequshqyer**

Në faqen 10

MJEKU POPULLOR

**Ylli Merja: Si të luftoni gripin e stinës me propolis e hudhër**

Në faqen 8

LETERKEMBIMI

**Dritëroi, Sadijes: Dimri, i vështirë për dashnorët. Me ty nuk do të mbretëronte kjo gjendje**

Në faqen 11

ARRESTIMI

**Morën 7 mijë euro ryshfet nga një biznes, ndalohen 2 inspektorë tatimorë**

Në faqen 12

TAKIMI

**"Forca e ligjit", 38 dosje nën hetim, Xhafaj takon Markun, Gjonajn dhe Ahmetajn**

Në faqen 5

Vendimi i qeverisë. Tabela e plotë e rrogave dhe shtesat për çdo kategori

# Strukturë e re pagash, sa do paguhen punonjësit e doganave

*Shtesa për kushte pune, për titullarët e institucionit 20000 lekë*

Nga ORNELA MANJANI

Qeveria miraton strukturë të re për sistemin doganor. Rritje pagash e shpërblime të majme për çdo punonjës do të aplikohen nga sot. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit doganor janë botuar dje në Fletoren Zyrtare dhe përveç rritjes së rrogave, punonjësit e këtij dikasteri do të trajtohen me shtesa mbi pagën për vështirësi në punë. Kështu, kreu i doganave do të marrë një shtesë mujore prej .. Në faqet 6-7

# PROTESTA
## OPOZITA

Masiviteti në protestë, PD grupe pune për angazhimin e qytetarëve në mbarë vendin

# Basha, thirrje shqiptarëve: Bashkë të largojmë qeverinë e krimit

## "Duam zgjedhje me drejtësi, jo blerje të pushtetit"

Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Një nga protestat e opozitës

**THIRRJA**
"Bashkohemi në një aksion të madh opozitar, që nis me protestën e 27 janarit, por që do të vazhdojë me dinamikë në çdo dimension. Për një arsye të thjeshtë. Edi Rama e ka humbur të drejtën të qeverisë. Kush i shërben krimit, nuk u shërben dot të varfërve", tha z.Basha.

Valentina Madani

Demokratët kanë zbritur në terren për organizimin e një proteste masive më 27 janar para godinës së Kryeministrisë. Strukturat e PD-së kanë nisur përgatitjet që pas datës 18 dhjetor, kur u vendos për një protestë tjetër, pasi ata kanë një peshë të madhe në tubimin e radhës. Mësohet se PD-ja ka ngritur një grup pune që do merret vetëm me elementet që do të përbëjnë protestën, si dhe një grup tjetër që do merret me angazhimin e qytetarëve në protestë. Për kreun e PD-së, Lulzim Basha, protesta e 27 janarit do të jetë nga më të fuqishmet që ka zhvilluar ndonjëherë e djathta shqiptare. Durrësi ishte ndalesa e radhës e z.Basha, nga ku ftoi shqiptarët t'i bashkohen opozitës për të bërë të mundur me votë të lirë ndarjen e qeverisë nga krimi. Basha tha se bashkimi është rruga e vetme për t'i dhënë fund pengmarrjes së Shqipërisë nga aleanca e Edi Ramës me krimin. "Bashkohemi në një aksion të madh opozitar, që nis me protestën e 27 janarit, por që do të vazhdojë me dinamikë në çdo dimension. Për një arsye të thjeshtë, Edi Rama e ka humbur të drejtën të qeverisë. Kush i shërben krimit, nuk u shërben dot të varfërve. Kush u shërben trafikantëve, nuk u shërben dot fëmijëve të shqiptarëve. Nuk bëhen dot të dyja. O njëra, o tjetra. Nuk ka vend për të qëndruar në mes", theksoi kreu i opozitës. Basha shprehu shqetësimin se duke asgjësuar lirinë e zgjedhjes, Edi Rama ka asgjësuar lirinë e çdo prindi për të siguruar të ardhmen e fëmijëve të tyre, ka asgjësuar lirinë e jetës duke shkatërruar shëndetësinë, ka shkatërruar lirinë e sipërmarrjes, motorit të vetëm të vërtetë të ndryshimit të Shqipërisë, që krijon vende pune. "Nëse votën e merr me kriminelët, nuk ndjen detyrim me njerëzit e thjeshtë, kaq e thjeshtë është. Kjo është arsyeja përse 49% e shqiptarëve nuk paguajnë dot faturën e dritës dhe të ujit. Kjo është arsyeja përse 30% e shqiptarëve nuk paguajnë dot nevojat minimale ushqimore. 39% nuk ngrohin dot shtëpitë. 70% e atyre që ikin janë nga mosha 19 deri 34 vjeç. Nuk e ka fare shqetësim. Shqetësim e ka si t'i mbrojë kriminelët e vet", u shpreh z.Basha. Kreu i opozitës përmendi se kryebashkiaku i Durrësit, i kapur duke u kërkuar kriminelëve blerjen e votave në shpërblim të tenderëve, është modeli i aleancës së Edi Ramës me krimin dhe se, bashkë me Ardian Çelën do të kenë të njëjtin fund. "Destini i tyre është para drejtësisë. Çfarë kërkojmë ne? Ne kërkojmë drejtësi. Ne kërkojmë drejtësi, sepse duam zgjedhje me drejtësi, jo blerje të pushtetit. Duam një drejtësi që ndëshkon krimin dhe korrupsionin, që ndëshkon Sajmir Tahirin dhe banditët e tij, që ndëshkon qeveritarët e korruptuar, që ka guximin të vendosë para drejtësisë dhe prapa hekurave këdo qeveritar dhe nevojë për numra, pasi opozita e gjithë bashkë nuk është se bën shumicën me numrat. Por kjo është një protestë morale, ne u ofrojmë qytetarëve të Shqipërisë solidaritetin kundër situatës në të cilën ndodhet vendi. Kemi besim se qytetarët shqiptarë do të na bashkohen në protesta", u shpreh z.Shehi.

## Protesta, Shehi: Bashkimi me LSI na sjell humbjen e disa votave

Kreu i LZHK, Dashamir Shehi komentoi angazhimin e përbashkët të opozitës për të protestuar kundër qeverisë "Rama" dhe situatës në të cilën ndodhet vendi. Në rubrikën "Opinion" në "News 24", Shehu theksoi se angazhimi i përbashkët i PD me LSI vjen në kuadër të situatës politike, ekonomike dhe sociale në vend. Nga ana tjetër, ai thotë se ky është një veprim i përbashkët në kuadër të protestave morale dhe jo bashkëpunim politik. Sipas Shehut, bashkimi i PD me LSI rrezikon të shkaktojë humbje të votave për PD-në. "Ne tani do të dalim në protesta kundër shtetit të korruptuar. Do të protestojë kundër shkeljes së Kushtetutës. Por, edhe PD vetë duhet të bëjë "mea culpa". Funksioni PD shkon përtej alternimit të pushtetit. Bashkimi me LSI na sjell humbjen e disa votave. Qëndrimin tonë ndaj LSI-së, ia kemi shprehur edhe kreut të PD-së, Lulzim Basha dhe kemi marrë përgjigjen që ne tashmë si opozitë do t'i kundërvihemi qeverisë së krimit. Por padyshim që PD ka qëndrimin e saj dhe duhet të ketë parimet e saj. Ne nuk kemi

**ERVIN SALIANJI**
"Reforma që do bënte të mundur shkëputjen e ndikimit politik tek prokuroria dhe gjykatat dhe do fuqizonte institucionet e drejtësisë duke zgjedhur profesionistë me veting! Sot pafuqia e institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm duket shteruese, përderisa pret në paradhomë të mbarojnë kafen Xhafaj-Gjonaj-Ahmetaj. 27JanarProtesto", tha Salianji.

## Protesta, Ristani: Ramës do i tregojmë se jemi shumë

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Arben Ristani, ndërsa mori pjesë në 27-vjetorin e themelimit të degës së PD-së në Berat bëri thirrje për pjesëmarrje masive në protestën e opozitës në 27 janar para Kryeministrisë. "T'u prijmë njerëzve tanë dhe t'u bëjmë thirrje edhe të tjerëve që të bashkohen me ne. Është koha për protestë, është leksioni i marrë nga 50-vjeçari i diktaturës komuniste, nuk mund ta lëmë të përsëritet. Këtë mund ta bëjmë vetëm duke u prirë protestave dhe duke i zhvilluar protestat që të mos lëmë Ramën të vjedhë demokracinë. Nuk presim që ta rrëzojmë që ditën e parë, por presim të kemi pjesëmarrje që të tregojmë se jemi bashkë me njerëz tjetrin, të tregojmë se jemi shumë, të tregojmë që revolta jonë është, zëri ynë është, që ne ekzistojmë, që ne jemi të fortë, që ne mund t'ia dalim", deklaroi sekretari i përgjithshëm i PD-së.

## Berisha: Habilajt morën peng agjentët e SHISH

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje një ngjarje të ndodhur më 20 korrik 2015 në një prej fshatrave të Vlorës, ku ishte kultivuar kanabis sativa. Sipas Berishës, dy agjentë të SHISH që mblidhnin informacione në terren për kultivimin e drogës, u zbuluan nga rojet e një parcele kanabisi. Ish-kryeministri shkruan se ata u morën peng dhe u dhunuan nga njerëzit e vëllezërve Habilaj. Në lidhje me këtë ngjarje ka qenë në dijeni dhe kryeministri, por nuk ka reaguar. "Denoncoj një rast të ndodhur në 20.07.2015 në një nga fshatrat e Vlorës, ku unë isha punëtor në parcelat e hashashit, të cilët ishin mbjellë nga vetë Habilajt. Një ditë kapen dy persona nga rojet e armatosura, të cilët kishin hyrë në parcelat e hashashit dhe po filmonin. Pas kapjes së personave, që në fillim u mendua se ishin gazetarë, por në të vërtetë ishin agjentë të SHISH, u goditën me grushte dhe shqelma që të tregonin përse kishin ardhur, më pas njëri nga pjesëtarët e bandës i njohur si Flori Dibrës, telefonon Policinë e Vlorës dhe i tregon ngjarjen dhe policia i kërkon që t'u bëhen foto personave të kapur dhe të lihen të lirë dhe nëse këta agjentë do të hapnin gojën, atëherë do merrej policia me ta, duke nënkuptuar se do ekzekutohen nga policia, sepse parcelat e Habilajve mbroheshin nga vetë Saimir Tahiri. Për këtë rast ne informuam vetë Ramën, por ai nuk reagoi!", thuhet në denoncimin drejtuar z.Berisha.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com,*** **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Deputeti i PD-së merr certifikatën e pastërtisë: Aplikova vullnetarisht

# Hapja e dosjeve, Gurakuqi: Si u zhdukën brenda 1 viti

## "Familjen time e dëbuan nga Tirana në 1948"

Valentina Madani

*Disa deputetë të PD-së kanë aplikuar vullnetarisht për marrjen e certifikatës së pastërtisë së figurës, e cila vërteton se nuk kanë lidhje me ish-Sigurimin e Shtetit. Njëri prej tyre është deputeti i qarkut të Shkodrës, z.Romeo Gurakuqi, i cili thotë për "Gazeta Shqiptare" se këtë veprim e mori vullnetarisht dhe i padetyruar nga askush. Por, z.Gurakuqi shpreh shqetësimin e tij për mënyrën se si veprohet për hapjen e dosjeve, pasigurinë e ruajtjes së tyre dhe zhdukjen në masën 70 për qind brenda 1 viti gjatë kohës që Ministria e Brendshme drejtohej nga Gramoz Ruçi. Romeo Gurakuqi flet edhe për dëbimin e familjes së tij nga Tirana në vitin 1948, ndërsa shprehet: "Dera e Shqipërisë duhet të jetë e hapur për bijtë dhe nipërit e mbesat e Shqipërisë së persekutuar, që u nxor jashtë me marifet nga viti 1991". Romeo Gurakuqi prej 7 vitesh punon në një projekt individual, që do të kurorëzohet në muajin shkurt 2018, të titulluar "Shqipëria dhe Tokat e Lirueme 1939-1946". Sipas tij, dy vite të kësaj historie kanë të bëjnë me vitet e para të ndërtimit dhe të veprimtarisë së organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, në Shqipëri dhe në Kosovë.*

### Alibeaj: Aplikova, pres të marr certifikatën e pastërtisë

Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj, i cili bashkë me familjen e tij ka vuajtur persekutimin e ashpër të regjimit komunist, është një tjetër deputetë i PD-së, i cili aplikoi dje për marrjen e certifikatës së pastërtisë. Z.Alibeaj i pyetur dje nga "Gazeta Shqiptare" lidhur me këtë vendim deklaroi: "Po, sot (dje) aplikova për marrjen e certifikatës së pastërtisë. Pas aplikimit pres të marr certifikatën. Vendimi im ishte në mënyrë vullnetare, i padiktuar nga askush". Aplikimi i tij u bë dje pranë institucionit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Aplikimi, kërkesa bëhet nga individët në mënyrë vullnetarë, ose nga kreu i institucionit i interesuar për këtë lloj informacioni dhe pastaj Autoriteti lëshon certifikatë me vërtetimin se individët e përfshirë në kërkesa kanë pasur apo jo lidhje me Sigurimin. Mësohet se nga PDja në mënyrë vullnetare certifikatën e pastërtisë e kanë marrë edhe deputetët Romeo Gurakuqi dhe Myslim Murrizi. Deputeti Enkelejd Alibeaj është në krye të grupit të punës që po merret me nismën e PD për ndalimin e simboleve të diktaturës komuniste, i cili nuk është parashikuar si një ligj i veçantë, por si ndryshime në Kodin Penal, që dënojnë çdokënd që i përdor ato.

Deputeti i PD-së i qarkut të Shkodrës, z.Romeo Gurakuqi

**DOSJET**

"Në çdo shtet normal, dokumenti shtetëror ruhet dhe garantohet me rreptësinë më të madhe, me kamera sigurie dhe me ruajtje fizike 24 orë. Për të ardhur keq, se punonjës të ish-strukturave të policisë së fshehtë mbikëqyrin punën e institucionit", tha z.Gurakuqi.

**Z.Gurakuqi është e vërtetë që ju keni marrë certifikatën e pastërtisë së figurës që nuk keni asnjë lidhje me ish-Sigurimin e Shtetit?**

Po, është e vërtetë që e kam marrë certifikatën nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. E kam bërë që në muajin korrik të vitit 2017 dhe brenda disa javëve kam marrë përgjigjen për pastërtinë e figurës.

**Keni aplikuar i detyruar apo në mënyrë vullnetare?**

Kam aplikuar në mënyrë krejtësisht vullnetare pa pasur detyrim nga askush. Nuk e kam bërë publike, sepse nuk mu duk e nevojshme një gjë e tillë. E bëra vullnetarisht dhe i padetyruar nga askush. E konsideroj një detyrim moral që kemi ndaj publikut.

**Kur keni aplikuar?**

Kam aplikuar 'online' në fund të korrikut 2017. Nuk kisha asnjë problem, por doja ta kisha këtë certifikatë para se të merrja mandatin e deputetit.

**Për sa kohë e keni marrë këtë certifikatë?**

Pas aplikimit 'online', jam informuar pas 3 javësh nga Autoriteti dhe kam shkuar dhe e kam marrë certifikatën e pastërtisë.

**Përveç jush, a ka zyrtarë të tjerë të PD-së që kanë vepruar njësoj si ju?**

Mesa jam unë në dijeni ka edhe të tjerë nga Partia Demokratike, që janë pajisur me këtë certifikatë.

**Besoni se marrja e certifikatës së pastërtisë duhet të jetë e detyruar dhe jo në mënyrë vullnetare?**

Për mendimin tim, duhet të jetë e detyruar në mënyrë të veçantë për Policinë e Shtetit, punonjësit e Ministrisë së Brendshme dhe për gjyqtarët e prokurorët, për administratën e lartë dhe institucionin më të lartë të shtetit. Sepse në organet e drejtësisë nuk mund të jenë individë që mund të kenë ushtruar dhunë tek të tjerët dhe as që kanë dëshmuar për dënimin e padrejtë të qytetarëve shqiptarë. E papranueshme pastaj është që brenda Autoritetit të Hapjes së Dosjeve, të kenë një sistem kontrolli të ushtruar nga ish-funksionarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të diktaturës.

**Ju personalisht a keni bashkëpunuar me Autoritetin e drejtuar nga zj.Sula?**

Po, kam bashkëpunuar me Autoritetin. Më kanë ofruar bashkëpunim për seancën parlamentare që u bë para pak kohësh për ekzekutimin pa gjyq të ish-deputetëve dhe intelektualëve nga regjimi komunist. Ndërkohë prej 7 vitesh punoj në një projekt individual që do të kurorëzohet në muajin shkurt 2018 të titulluar "Shqipëria dhe Tokat e Lirueme 1939-1946". Dy vite të kësaj historie kanë të bëjnë me vitet e para të ndërtimit dhe të veprimtarisë së organeve të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri dhe në Kosovë.

**Si e vlerësoni ngritjen dhe punën e deritanishme të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit?**

Është një hap i rëndësishëm, por mbi të gjitha duhet rregulluar raporti mes këtij Autoriteti dhe Arkivit të Ministrisë së Brendshme. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme është veç një magazinë, që nuk ka asnjë ngjashmëri me një arkiv normal. Hapi i parë që do të duhet të bëhet për të rregulluar rrugën drejt funksionalitetit të Autoritetit të Dosjeve, duhet të jetë shndërrimi i Arkivit të MPB në një institucion të mirëfilltë arkivor, modern dhe të ngjashëm me vendet e tjera europiane post-komuniste. Autoriteti i Hapjes së Dosjeve është një institucion i pavarur, i cili ka të drejtë të operojë në Arkivin e MPB (që është i pavarur nga Autoriteti i Hapjes së Dosjeve), në sektorët e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Imagjinojeni ju si operohet dhe si zgjidhet raporti në mes punës së Autoritetit të Hapjes së Dosjeve dhe Arkivit të MPB, i pavarur nga ai: a ka një rregullore që garanton që dosjet janë të paprekshme dhe a ruhen dosjet e Arkivit të MPB nga një sistem i tretë i sigurisë shtetërore të informacionit?

**Ju po thoni se dosjet nuk janë të sigurta...**

Asnjë garanci nuk ka për këtë dhe asnjë procedurë të përcaktuar për ruajtjen, për arsye publike të dosjeve që një autoritet tjetër, siç është Autoriteti i Hapjes së Dosjeve, i merr në shqyrtim nga fondet e Arkivit të MPB? Kini parasysh pra se dosjet e Arkivit të MPB nxirren jashtë hapësirës së ruajtjes drejt të autoriteti tjetër.. Një mishmash i vërtetë procedural. Përveç kësaj, asgjë nuk ka rregulluar ligji mbi funksionalitetin e Autoritetit të Dosjeve, në institucionet të tilla si AQSH, dosjet e divizioneve, që kanë bërë raprezaljet në fund të vitit 1944 dhe gjatë gjithë vitit 1945 në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë. Asgjë nuk ka rregulluar ligji mbi tagret e verifikimeve dhe procedurat e përcaktuara qartë të vjeljes së informacionit dhe hapjes së dosjeve në Arkivin e Forcave të Armatosura, pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe në Arkivin e MPJ.

**Si mund të bëhet funksional ligji i hapjes së dosjeve?**

Mbi të gjitha, për ta bërë funksional ligjin e hapjes së dosjeve duhet të rregullohen kushtet e punës së Autoritetit të Dosjeve. Institucioni e ka selinë diku pranë Gardës së Republikës, ndërkohë fondi i burimeve ndodhet në disa depo të lëna mënjanë pranë ish-Shkollës së Bashkuar. Imagjinojeni ju vetë si realizohet një procedurë normale në atë institucion! Imagjinojeni vetë sigurinë e ruajtjes së informacionit! Këtu nuk është çështje e pabesueshmërisë së punonjësve. Nuk është fjala këtu. Në çdo shtet normal, dokumenti shtetëror ruhet dhe garantohet me rreptësinë më të madhe, me kamera sigurie dhe me ruajtje fizike 24 orë. Po ashtu, nga 66 veta administratë organike, institucioni i dosjeve funksionon sot me 18 veta. Opozita desidente e papërfaqësuar fare në pikëpamje thelbësore profesionale dhe jo politike. Për të ardhur keq, se punonjës të ish- strukturave të policisë së fshehtë mbikëqyrin punën e institucionit. Thënë ndryshe, rezulton se politikisht vendimmarrësit e kësaj sipërmarrjeje praktikisht kanë hedhur një fasadë, por nuk kanë arritur të ndërtojnë të gjithë mekanizmin real të funksionimit të këtij institucioni. Përveç kësaj, duhen dhënë shpjegime për eliminim e dosjeve, shkatërrimin e tyre gjatë vitit 1990 dhe fillimit të vitit 1991, si dhe të jepet një fond për gjetjen e të zhdukurve, pasi ka njerëz të pushkatuar, që nuk u gjenden eshtrat dhe nuk dihet vendi ku janë varrosur.

**Sipas jush, a janë manipuluar dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit?**

Nuk besoj, por jam i bindur se dosjet në masën 70 për qind janë zhdukur. Dosjet nuk janë mbyllur, por janë zhdukur.

**Në cilën periudhë ka ndodhur zhdukja e dosjeve?**

Zhdukja e dosjeve ka ndodhur në arkivat e Degëve të Punëve të Brendshme të varura nga Ministria e Brendshme dhe nga ish-Sigurimi i Shtetit, ka ndodhur në fund të vitit 1990 dhe në fillim të vitit 1991, sipas rrëfimeve të pakontestuara deri më tani. Titullarët e këtyre institucioneve të asokohe duhen pyetur për fatin e tyre. Verifikoni kush ka qenë në krye të këtyre institucioneve dhe pyetini. Është detyrim i shtypit për ta filluar së pari hetimin për interesa publike.

**Në atë kohë Ministria e Brendshme është drejtuar nga Gramoz Ruçi, por si e shpjegoni faktin që tashmë ai është në krye të Kuvendit të Shqipërisë?**

Është rrjedhim logjik i të gjitha zhvillimeve që ka pësuar Shqipëria në aspektin e kontrollit politik majtist të lirisë, në periudhën pas vitit 2013. Për fat te keq, vendi ka bërë hapa prapa dhe imagjinojeni ju tani, kur përfaqësuesit e ish-institucioneve të diktaturës janë strukturues të organit të hetimit, orientojnë hetimin dhe ndërtojnë edhe drejtësinë e re. Vendi ka pësuar hapa prapa dhe kjo duhet të ndalet.

**A është persekutuar familja juaj nga regjimi komunist?**

Jemi nxjerrë jashtë prej Tiranës në vitin 1948, nga shtëpia jonë në lagjen "Abdullah Bej", rruga "Ali Pashë Gucia". Kryetari i Degës së Punëve të brendshme të asaj kohe, Besim Selita, ka qenë ideatori dhe realizuesi i deportimit të familjes dhe rekrutimit të detyruar në ushtri të babait tim, universitar, i kthyer nga studimet nga Universiteti i Firences. Regjimi deportonte familjen e gjyshit tim, aktivist i Rilindjes dhe Pavarësisë, bashkëthemelues i gazetës "Bashkimi i Kombit", Manastir 1909; themelues i Postës Shqiptare dhe pjesëmarrës i opozitës Noli-Gurakuqi-Vinjau. Për fat kjo kthesë në jetën e familjes është shumë pak në krahasim me atë çfarë kanë vuajtur mijëra dhe mijëra familje të Tiranës, Shkodër, Durrësit dhe të gjithë Shqipërisë, që nga agimi i 17 nëntorit 1944.

**Çfarë duhet të bëjë PDja më tepër për shtresën e ish- të përndjekurve politikë?**

Përfaqësuesit e desidencës së mirëfilltë, liberaldemokratike do të vazhdojnë të përforcojnë bazamentin politik të PD-së. Radha e punëve të mira për këtë shtresë duhet t'u shtohet punëve pararendëse të bëra në kohë, me qëndrueshmëri. Para së gjithash, duhet të kujtoj se përfaqësuesit e brezit të ri të kësaj shtrese më së shumti nuk jetojnë në Shqipëri. Klasa politike në kohë të ndryshme i ka nxjerrë jashtë, dera e Shqipërisë duhet të jetë e hapur për bijtë dhe nipërit e mbesat e Shqipërisë së persekutuar që u nxor jashtë me marifet, nga viti 1991. Kjo është e para gjë ku duhet të insistohet. Më pas janë çështjet e tjera të pazgjidhura.

### Presidenti pret kryekomunarët e Skënderajt e Drenasit

## Meta: Bashkëpunim e projekte të përbashkëta mes bashkive të Kosovës e Shqipërisë

Presidenti Ilir Meta priti dje në takim kryetarin e komunës Drenas, Ramiz Lladrovci dhe kryetarin e Skënderajt, Bekim Jashari. Meta shprehu kënaqësinë për këtë takim, me drejtuesit e këtyre dy komunave të Drenicës, si dhe vuri në dukje kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë zona e Drenicës në historinë e kombit tonë. Presidenti theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi në mes bashkive të ndryshme të Shqipërisë me komunat e Skenderajt dhe të Drenasit, por edhe me komunat e tjera të Kosovës, në realizimin e projekteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me kulturën, arsimin, sportin, bujqësinë, si dhe me të gjitha fushat e tjera të jetës. Ilir Meta, në mënyrë të veçantë u interesua për hartimin dhe përgatitjen e projekteve të përbashkëta mes të bashkive të Shqipërisë dhe komunave të Kosovës, në kuadrin e programeve evropiane për zhvillimin e rajoneve. Po dje, Presidenti Meta priti rekordmenin shqiptar, kampionin e Evropës në kërcim së gjati, Izmir Smajlaj dhe presidentin e Federatës Shqiptarë të Atletikës, Gjergj Ruli, të cilëve në prag të fillimit të garave të rëndësishme ndërkombëtare u uroi sa më shumë suksese dhe medalje për Shqipërinë në këtë Vit të Skënderbeut.

### Përplasen dy themeluesit, shpallin dy njoftime për mbledhje të bërthamës së partisë

# Hafizi thërret kryesinë e LIBRA-s. Blushi: Është nul

## *Ish-deputetja: Partia sot është e rrudhur dhe e fjetur*

Darina Tanushi

Përplasja mes dy themeluesve të LIBRA-s, Ben Blushit dhe Mimoza Hafizit vijoi dje për mbledhjen e bërthamës, siç e quajnë ata kryesinë e parisë. Ka qenë Mimoza Hafizi, ajo e cila përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka thirrur në një mbledhje bërthamën e partisë së re, duke përcaktuar 12 janarin si ditën e takimit. Ndërkaq, nga ana tjetër ajo nuk ka kursyer edhe akuzat për kreun e LIBRA-s, Ben Blushin, ndërsa shton se nuk ka pranuar të mbledhë bërthamën që prej datës 13 korrik të vitit të shkuar. Pas këtij publikimi në faqen e Hafizit, në faqen e LIBRA-s ka dalë një tjetër njoftim, ku thirret mbledhja e bër-thamës sot pasdite në të njëjtin mjedis ku disa javë më parë plasi grushti mes anëtarëve të LIBRA-s, në prani edhe të Ben Blushit. "Çdo përpjekje për të mos lejuar mbledhjen e bërthamës apo zëvendësuar me takime paralele është uzurpim institucional brenda partisë. Takimet me elektoratin apo aktivistët mund të kenë vetëm karakter konsultues. Prej 6 muajsh, z. Blushi nuk pranon ta mbledhë këtë bërthamë. Mbledhja e fundit e saj është zhvilluar në datën 13 korrik 2017. Në këto kushte, në përputhje me përcaktimet e statutit LIBRA, më tepër se 1/3 e anëtarëve të bërthamës kanë kërkuar mbledhjen e saj, me datë 12 janar 2012", shprehet Hafizi në njoftimin e saj. Në thirrjen drejtuar 30 anëtarëve të bërthamës, Hafiz shprehet: "Në kushtet

Ben Blushi dhe Mimoza Hafizi

që jemi, LIBRA është sot një institucion i rrudhur, një instrument i fjetur politik, edhe pse në fazat e para të formimit institucional. Nisur nga këto konstatime dhe të bindur se e ardhmja, pritshmëritë dhe fati i lëvizjes varen sot ekskluzivisht nga vullneti dhe pasioni ynë i përbashkët, një grup nismëtar (anëtarë të zgjedhur të bërthamës) kërkojnë si më funksionet në mënyrë jozyrtare, analizë e situatës së brendshme dhe zhvillimeve në LIBRA, si dhe pozicionimit të saj aktual politik". Por, në njoftimin e LIBRA-s, të administruar nga Blushi thuhet: "Ditët e fundit, përmes një email-i, disa anëtarë të LIBRA-s kanë kërkuar një mbledhje bërthame në datën 12 janar ora 19.15 në një nga hotelet e

> **PERPLASJET**
>
> "Çdo përpjekje për të mos lejuar mbledhjen e bërthamës apo zëvendësuar me takime paralele është uzurpim institucional brenda partisë. Takimet me elektoratin apo aktivistët mund të kenë vetëm karakter konsultues".

poshtë: Mbledhje të bërthamës LIBRA". Mbledhja do të ketë këtë rend dite, sipas Hafizit: "Sqarimi dhe përcaktimi i statusit të secilit prej anëtarëve të bërthamës, që kanë dhënë dorëheqje nga Tiranës, në të cilën kërkojnë që të rishihen dorëheqjet e disa anëtarëve të saj, të cilët janë larguar me vullnet të lirë". Më pas në këtë status thuhet se 5 vetë kanë dhënë dorëheqjet dhe për pasojë nga lista e 14 nënshkruesve që kërkojnë mbledhje, ajo reduktohet në 9 anëtarë. Kjo shifër nuk plotëson numrin e mjaftueshëm sipas statusit për të kërkuar mbledhjen e forumit. Duke e konsideruar kërkesën e anëtarëve të LIBRA-s që mbështesin Hafizin, pjesa e mbështetësve të Blushit njofton mbledhjen sot në ora 18.30, tek hotel "Monarku". "Kushdo që ka shqetësime të çdo karakteri, personal, privat apo politik dhe ka kurajën të thotë publikisht se çfarë do dhe çfarë kërkon është i ftuar, natyrisht me përjashtim të atyre që janë larguar me vullnet dhe nuk ka arsye të ftohen më. Në këtë mbledhje të thirrur nga kryetari do të merren vendime në lidhje me shkeljet e statutit për të gjithë anëtarët e bërthamës si dhe do diskutohet për qëndrimet e ditëve të ardhshme si dhe riorganizimin e partisë. Çdo mbledhje tjetër, që cenon statutin do të konsiderohet e paligjshme dhe për pasojë e pavlefshme ose nul", thuhet në njoftimin e Blushit.

> **PETRO KOÇI**
>
> "Shuarja e iluzionit se LSI mund t'i rikthehej një ditë bashkëpunimit me të majtën dhe ulja e saj në prehrin e PD-së e redukton në masë të konsiderueshme bazën zgjedhore të kësaj partie", tha dje, zv.ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, përmes një statusi të tij në "FB".

## Spiropali: Në partitë e tjera ka ushtarë, i patë vajzat e LSI-së në Parlament?

Sekretarja socialiste për rininë në PS, njëherësh edhe koordinatore kombëtare për bashkëqeverisjen, Elisa Spiropali zhvilloi një takim me strukturat e FRESSSH-it, ku kërkoi mobilizim të të gjithë të rinjve që të mbushin pallatin e sportit dhe të sfidojnë po ashtu edhe protestën e opozitës të 27 janarit. Gjatë fjalës së saj, ajo mori si shembull negativ për të rinjtë e PS-së, LSI-në. "Dhe në parti të tjera ka të rinj, por janë ushtarë, i keni parë ato vajzat që ka futur LSI në Parlament? I keni parë sesi janë? Të jesh i ri, nuk është vlerë, por të kesh risi dhe të sjellësh risi, është një vlerë", tha Spiropali në fjalën e saj, raporton "newsbomb.al". "Ne fituam vetëm dhe u kërkuam njerëzve të na besonin. Të na besonin se do të hiqnim pazarxhinjtë dhe tepsixhinjtë nga administrata", vazhdoi analizën Spiropali, duke iu referuar sërish zyrtarëve të LSI-së, e cila ka qenë forca aleate qeverisëse e PS në mandatin e kaluar. "Ne do të vlerësonim meritën te njerëzit. Njerëzit na besuan dhe ne duhet tua kthejmë këtë besim", tha ajo. Spiropali u foli të rinjve për rëndësinë e çeljes së negociatave me BE. "Kanë dalë disa forca politike që duan të kthejnë pas Shqipërinë. E tregojnë me aksione në Parlament, por edhe në forma të tjera. Pse kujtoni ju se i hodhi çizmet ajo në Parlament? Apo tymin? Se nuk donin prokuroren? Jo, sepse janë kundër reformës", tha Elisa Spiropali para të rinjve. "Ndaj, në 14 janar ne duhet të provojmë që kemi entuziazëm dhe që rinia është me ne. Të sfidojmë protestën e 27 janarit, të atyre, sepse janë njerëz të diskretituar, që duan të diskretitojnë edhe Shqipërinë", tha Spiropali.

> "Ne do të vlerësonim meritën te njerëzit. Njerëzit na besuan dhe ne duhet tua kthejmë këtë besim".


**NJOFTIM ANKANDI**

**PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT ARTAN SIMA**

**Datë 19/01/2018, ditën e Premte ,ora 16,00** perfundon ankandi i ri (i parë) , për shitjen e pasurisë së paluajtshme lenë garanci nga debitori z. Ramadan Ibrahim Kordallibanues ne Bilisht ,Bashkia"Devoll" për detyrimin ndaj kreditorit : znj.Lindita Bere Kordalli, banuese ne fshatin"Tren",Rrethi Devoll .
"Apartament" me sipërfaqe totale 73.40 m2 e ndodhur në Bilisht, në vlerën 1.440.000 lekë.

**Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 .k,1. Korce.**
**Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com**

**NJOFTIM ANKANDI**

**PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT ARTAN SIMA**

**Datë 19/01/2018, ditën e Premte ,ora 16,00** perfundon ankandi i ri (i parë) , për shitjen e pasurisë së paluajtshme lenë garanci nga debitori z.Artur Dilaver Hasani dhe bashkpronaret z.Dilaver Ramo Hasani , z.Edmond Hasani , znj.Luiza Dilaver (Hasani) Hoxha banues ne,Rr" 28 Nentori" ,L.5,P.2,Shk.B,Nr.9, Korce për detyrimin ndaj kreditorit : z.Rexhep Shaban Furramani,Rr.Hasim Vokshi,L.7,Nr.35,Korce.
"Apartament" me siperfaqe 63.10 m2,ndodhur ne Rr"28-Nentori", pll.2, shk.2, k.5,ap.9, Korce, në vlerën 1.600.000 lekë.
**Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 .k,1. Korce.**
**Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

PASURINË NR. 2/963-ND+1-43 , E LLOJIT 'APARTAMENT' , VOLUMI 55 , FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513 , ME SIPËRFAQJE 67,81 M2 , NË ADRESËN : RRUGA "K. KËRTUSHA" , SHKALLA 1 , KATI 7 , DURRËS , NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .
**ÇMIMI 2.800.000 LEKË ", Data e zhvillimit të ankandit do jetë 19.01.2018 .**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

38 dosje nën hetim, plan veprimi kundër krimit të organizuar në Shqipëri dhe jashtë saj

# Operacioni "Forca e ligjit", Xhafaj takon Markun, Gjonajn dhe Ahmetajn

## *Në fokus bandat kriminale dhe pasuritë e krijuara*

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj ka zhvilluar ditën e djeshme një takim ku mori pjesë kryeprokurorja e përkohshme Arta Marku, ministrja e Drejtësisë Etilda Gjonaj, ministri i Financave, Arben Ahmetaj. Gjithashtu, të pranishëm në mbledhje kanë qenë dhe zv. drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, Helidon Bendo, Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar i Policisë së Shtetit Rebani Jaupaj si dhe Drejtori i SHÇBA-së Eduart Merkaj. Mbledhja u zhvillua në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit", i cili ka në fokus luftën ndaj grupeve kriminale dhe pasuritë e krijuara nga kjo veprimtari. Mësohet se takimi zgjati rreth 45 minuta. Gjatë takimit, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj njohu anëtarët e Task Forcës Qendrore Ndërinstitucionale me ecurinë e procesit gjatë muajit dhjetor 2017, hartimin dhe miratimin e kuadrit të nevojshëm ligjor, masat e marra për ngritjen e strukturave për të thithur në to ekspertizën më të mirë në fushën e hetimit policor dhe krijimin e mjediseve të përshtatshme të punës.

Takimi duket se vjen pas hartimit të një raporti mbi 38 dosjet e krimit, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri dhe më gjerë, të cilët pas nisjes së aksionit policor po përdorin mënyra të ndryshme për të fshehur pasuritë e tyre, si duke i legalizuar apo duke i kaluar ato në emrat e personave të tretë, deklaron "Report tv". Teksa është nënvizuar se vetingu në drejtësi dhe në policinë e shtetit do të japë rezultate konkrete në luftën ndaj krimit. Mësohet se ministri Xhafaj ka njohur Markun dhe ministrat me dosjet e bandave të krimit. Sakaq anëtarët e TFQN diskutuan mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre institucionale, koordinimin e procesit dhe garantimin e mbështetjes në vijim, për Task Forcën Speciale në nivel qendror dhe rajonal, si struktura të posaçme të ngarkuara me përgjegjësi operacionale. Ata u dakordësuan për mbështetjen që secili prej tyre do t'i japë këtij procesi përmes Agjencive respektive të zbatimit të ligjit, për përmirësimin e kuadrit normativ që lehtëson këtë bashkëveprim, përfshi dhe marrëveshjet e protokollet e bashkëpunimit përkatës, në respekt e zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Ky ka qenë takimi i dytë mes Markut dhe Xhafajt, ndërsa takimi i parë mes tyre është bërë në zyrën e kryeprokurores, pak kohë pasi ajo u votua ne Kuvend. Gjithashtu, Prokurorja e Përgjithshme e përkohshme, Arta Marku zhvilloi pasditen e djeshme një takim me ambasadoren e Bashkimit Europian në vendin tonë, Romana Vlahutin. Takimi i Markut me ambasadoren zgjati rreth 50 minuta në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme. Ky takim u zhvillua pas një vale shkarkimesh në Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve.

Kryeprokurorja e përkohshme, Arta Marku, pas takimit të djeshëm

**OPERACIONI "FORCA E LIGJIT"**

Takimi u zhvillua në kuadër të operacionit "Forca e ligjit", i cili ka në fokus luftën ndaj grupeve kriminale dhe pasuritë e krijuara nga kjo veprimtari. Mësohet se mbledhja zgjati rreth 45 minuta. Takimi duket se vjen pas hartimit të një raporti mbi 40 grupet kriminale që veprojnë në Shqipëri.

### Ligj për të miturit, kodi i ri për t'i mbrojtur nga krimi, rehabilitim dhe jo dënim

Të miturit që kryejnë vepra penale, apo që janë të dëmtuar dhe dëshmitarë të veprave penale, tashmë do të trajtohen sipas një kodi të ri që ka hyrë në fuqi në 1 janar të këtij viti. Ky kod parashikon standardet më të mira të së drejtës për të miturit me qëllimin kryesore rehabilitimin dhe jo dënimin e tij. Por kërkesat e kodit, duket se kanë nxjerrë disa sfida për sistemin e drejtësisë, i cili nuk është plotësisht gati që ta zbatojë ketë kod germë më germë. Dhe këto sfida nisin që nga trajnimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve që do të shqyrtojnë çështjet e të miturve. Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe personeli i tyre është një tjetër sfidë në zbatim të Kodit të ri për të miturit, i cili parashikon rehabilitimin nën kujdesin e institucioneve të certifikuar. Alternativa e fundit e kodit të ri, që është paraburgimi ose burgimi, parashikon që qelitë e të miturve duhet të jenë plotësisht të veçuara nga ato të tjerëve dhe shmangien e çdo kontakti me të burgosurit e tjerë. "Brenda 6 muajve në një nisme së bashku me policinë e shtetit dhe drejtorinë e përgjithshme të burgjeve, duhet të sjellim në parametra dhe kushte siç i parashikon kodi qelitë për të miturit.

### "Nuk do të qëndroj më në zyrë, s'çahet me kokëfortësi"

## Ish-kryeprokurori i Elbasanit, padit Arta Markun: Transferimi im, antiligjor

Dritan Gina, i liruar dy ditë më parë nga detyra si drejtues i komanduar i prokurorisë së Elbasanit, ka depozituar ditën e djeshme një padi pranë krimeve të rënda, për shpërdorim detyre për kryeprokuroren e përkohshme Arta Marku. Gina, gjithashtu, deklaroi se nuk do të vazhdojë të qëndrojë në zyrë, duke shtuar se në Shqipëri nuk çahet me kokëfortësi. "Unë jam profesionist, unë e kuptoj që me kokëfortësi nuk çahet. Nuk pretendoj të rri në atë zyrë, pasi puna e prokurorit ka të bëjë me raportin administrativ dhe përfaqësimin, që ka të bëjë me thesarin, etj. Pasi firma ime nuk njihet më, por edhe zyrat e shtetit që nuk e njohin më firmën time. Reagimi dje ishte i një prokurori që nuk lejon të nëpërkëmbë mua apo kolegët. Këtu është bërë Shqipëri hesapi",-tha ish-kryeprokurori i Elbasanit. Në padinë prej 15 faqesh, Gina e cilëson transferimin e tij, antiligjor dhe në tejkalim të kompetencave nga kryeprokurorja Marku. "Pas një presioni dhe përndjekje dyjavore të ushtruar ndaj bashkëshortes sime Rovena Gashi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe pas paraqitjes prej saj në datën 08.01.2018, në Gjykatën Administrative, të padisë ndaj Prokurores së Përgjithshme të përkohshme, kjo e fundit në shenjë hakmarrje, kundrejt një sulmi dhe shantazhi të drejtpërdrejtë, të ushtuar gjatë gjithë ditës së martë, në datën 09.01.2018 në orën 15:20, më ka njoftuar me shkrim Urdhrin Nr.13 datë 09.01.2018 për ndërprerjen e komandimit", -shkruan Gina në padi. Gjithashtu, ish-drejtuesi i prokurorisë së Elbasanit, Dritan Gina në këtë padi, kërkon pezullimin nga detyra të kryeprokurores Arta Marku dhe urdhërimin e kryerjes ndaj saj të ekspertizës psikiatriko-ligjore. Sipas tij këto masa duhen marrë për të penguar vijimin e veprimtarisë antiligjore të kryeprokurores së përkohshme, Marku. "Kërkoj që, në bazë të këtij kallëzimi penal, fakteve shumë të rënda të kallëzuara dhe të konfirmuara shkresërisht, nëpërmjet akteve, veprimeve dhe vendimeve antikushtetuese dhe të paligjshme të ndërmarra nga ana e Prokurores së Përgjithshme të përkohshme të Republikës së Shqipërisë, të regjistrohet procedimi penal, kjo funksionare shpërdoruese të merret në cilësinë e të pandehurës për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe të bëhet kërkesë për dërgimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të saj. Referuar gravitetit të shpërdorimit të detyrës të kryer nga ana e të kallëzuarës, me dashje direkte dhe me veprime aktive kriminale, duke përdhosur Kushtetutën dhe mos përfillur ligjin, referuar densitetit dhe vazhdimësisë së veprimtarisë kriminale të saj, të cilat dëmtojnë vetë interesat e ligjshme të shtetit, paraprakisht kërkojmë që, menjëherë pas regjistrimit të këtij kallëzimi penal, ndaj personit të kallzuar, për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore të saj, të merret masa e sigurimit personal ndaluese, e "Pezullimit të ushtrimit të detyrës publike", të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale"- shkruan Dritan Gina në kallëzimin penal.

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**

Permbaruesi gjyqesore **Genti Bushati** nxjerr per shitje ne ankand pasurine :
"Toke Are truall nr pasurie 222/11, vol 4 , faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trush , Njesia Administrative Berdice , bashkia Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren 515,200 (pesegind e pesembedhjetemije e dyqind) leke
Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date **15.01.2018 ora 16.16** ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1- "Truall" me sip. 200 m² nga kjo ndretese 114 m2,Nr. pasurie 9/584, Vol. 27, Faqe 87, ZK 8532 i ndodhur ne Sheq i Madh, Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është **9.472.000 Leke.** Ankandi per do te zhvillohet **datë 22.01.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane
2- "Are" me sip. 9.159 m²,Nr. pasurie 117/37, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur ne Sheq , Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është **16.852.160 Leke.** Ankandi per do te zhvillohet **22.01.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane .
Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al.

# VENDIMI I QEVERISE
## STRUKTURA E RE

Tabela e plotë e rrogave dhe shtesat për çdo kategori

# Strukturë e re pagash, ja sa do të paguhen punonjësit e doganave

## *Shtesa për kushte pune, për titullarët e institucionit 20000 lekë*

Ornela Manjani

Qeveria miraton strukturë të re për sistemin doganor. Rritje pagash e shpërblime të majme për çdo punonjës do të aplikohen nga sot. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit doganor janë botuar dje në Fletoren Zyrtare dhe përveç rritjes së rrogave, punonjësit e këtij dikasteri do të trajtohen me shtesa mbi pagën për vështirësi në punë. Kështu, kreu i doganave do të marrë një shtesë mujore prej 20 mijë lekësh për vështirësi në punë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të fillojnë nga data e transferimit të nëpunësve të sistemit të doganave në pozicionet e reja të punës dhe të do përballohen nga fondet e miratuara për këtë sistem, për vitin 2018. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

është 1 102 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor. Në Fletoren Zyrtare është botuar dje vendimi i Këshillit të Ministrave për "për personelin e administratës doganore", të ndryshuar, i cili parashikon që Drejtori i Përgjithshëm i Doganave miraton rregulloret specifike të funksionimit të drejtorive e të degëve doganore, si dhe aktet e tjera të nivelit të tretë, si: vendime, urdhra, udhëzime etj., në varësi të nevojave të punës. Për të siguruar administrimin efektiv dhe përmbushjen e misioneve, kompetencave dhe detyrave funksionale të administratës doganore, drejtori i përgjithshëm i Doganave bashkëpunon dhe bashkërendon punën nëpërmjet zëvendësdrejtorëve dhe drejtuesve, që ka në varësi të drejtpërdrejtë.

Me strukturën e re është parashikuar edhe krijimi i sektorit i monitorimit të borxhit. Kjo drejtori ka për detyrë mbledhjen e të dhënave për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe joshqiptare, që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, monitorimin dhe detajimin e planit të të ardhurave, analizimin e të dhënave, objekt të vlerësimit nga zyrat e interesuara dhe autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke e zgjeruar fushën e përgjegjësive edhe me studime e analiza të realizimit të të ardhurave dhe mallrave kryesore. Gjithashtu, kjo drejtori administron procedurat për regjistrimin e operatorëve në sistemin doganor, lindjen dhe rikuperimin e borxhit, përgatitjen dhe administrimin e udhëzimeve për kontabilizimin e të ardhurave nga detyrimet e importit, eksportit ose akcizës, për vjeljen e detyrimeve dhe rimbursimin ose shlyerjen e borxhit, si dhe monitoron procedurat për rikuperimin dhe vjeljen me forcë të borxhit.

### ANTITRAFIKU

Drejtoria Antitrafik mund të shkëmbejë të dhëna me struktura të tjera doganore apo shtetërore, me kompetenca në fushën e zbatimit të ligjit për mallra, mjete apo subjekte, me qëllim parandalimin dhe goditjen e shkeljeve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi kundër trafiqeve. Ajo bashkëpunon me agjenci, institucione dhe aktorë të tjerë, përfshirë ata ndërkombëtarë, të cilët kanë detyrime ligjore ose që janë të angazhuar në luftën kundër trafiqeve dhe zbatimin e masave ndaluese, kufizuese.

### ORGANIKA E ADMINISTRATËS DOGANORE ËSHTË E PËRBËRË NGA:

**i)** Drejtori i përgjithshëm i Doganave.
**ii)** Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Doganave.
**iii)** Drejtori i kabinetit.
**iv)** Nëpunës kategoria A.
**v)** Nëpunës kategoria B.
**vi)** Nëpunës kategoria C 1.
**vii)** Nëpunës kategoria C 2.
**viii)** Punonjës administrativ kategoria C3.
**ix)** Punonjës administrativ kategoria D1.
**x)** Punonjës administrativ kategoria D2.
**xi)** Punonjës administrativ kategoria D3.

## STRUKTURA E RE PËR SISTEMIN DOGANOR

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHTESAT PËR KUSHTE PUNE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT DOGANOR

| Klasifikimi doganor | Pozicioni | Kategoria | Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit | Shtesa e pozicionit (SHP) | Shtesa për kushte pune |
|---|---|---|---|---|---|
| | Titullari i institucionit | II-a | 1 | | 20000 |
| | Zëvendësdrejtori i përgjithshëm | II-b | 1 | | 15000 |
| A | Drejtor Kabineti, Këshilltar, Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme, Përfaqësues SELEC në DPD<br>Kryetar i degës doganore të kategorisë A sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave në vendim përkatës për personelin e administratës doganore | III-a | 1 | | 15000 |
| B | Përgjegjës sektori në DPD<br>Kryetar i degës doganore të kategorisë B, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave në vendim përkatës për personelin e administratës doganore<br>Përgjegjës sektori në degët doganore të kategorisë A | III-a/1 | 1 | | 14000 |
| C1 | Në DPD:<br>Auditues, Specialist, Specialist laborant, Komandant Grupi Antikontrabande, Specialist QNOD, Përgjegjës syre<br>Në degët doganore:<br>Përgjegjës syre/turni, Specialist (analist riziku, apostelues, jurist, hostni, | III-b | 1 ose 2 | | 14000 |
| | administrator sipërfaqesh, financier) | | | | |
| C2 | Në DPD:<br>Inspektor antikontrabande, Asistent laborant, Specialist GPI, Doganier klasifikimi/vlerësimi/apostelor<br>Në degët doganore:<br>Specialist financë i nivelit të dytë, Doganier klasifikimi/vlerësimi/kontrolli fizik/skaner/aktivist/apostelor/regjistrim/performancë/përjashtime | IV-a | 1 ose 2, ose 3 | | 10000 |
| C3 | Në DPD:<br>Sekretar/protokoll, Arkivist, Përpunues informacioni, Doganier pike kontrolli<br>Në degët doganore:<br>Doganier pedinoxe/pike kontrolli, Sekretar, Arkivist | | | 40000 | 5000 |
| D1 | Në DPD:<br>Magazinier, Teknik marinë/motorist, Teknik mirëmbajtje, Shofer.<br>Në degët doganore:<br>Magazinier | | | 37000 | |
| D2 | Punëtor mirëmbajtjeje në degët doganore. | | | Klasa IV Sipas VKM-së për pagat e punonjësve mbështetës | |
| D3 | Sanitar/punonjës pastrimi në DPD dhe degët doganore. | | | Klasa I Sipas VKM-së për pagat e punonjësve mbështetës | |

| Emërtimi i postit | | Funksioni | Kategoria | Nr. i punonjësve | Kategoria e pagës |
|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm | | Drejtor i Përgjithshëm | II-a | 1 | II-a |
| | | Këshilltar për çështje teknike | A | 1 | III-a |
| | | Drejtor kabineti | A | 1 | III-a |
| | | Këshilltar | A | 3 | III-a |
| | | Sekretar i drejtorit të Përgjithshëm | C3 | 1 | |
| TOTALI | | | | 7 | |
| Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | 5 | |
| Drejtoria e Auditimit të Brendshëm | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | Auditues | C1 | 7 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | 8 | |
| Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | Specialist | C1 | 5 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | 6 | |
| Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i planifikim-monitorim buxheti | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | Sektori i financë/kontabilitetit | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | | Magazinier | D1 | 2 | |
| | Sektori i pagesave, garancive dhe kontabilitetit të të ardhurave | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |
| | | Specialist | C1 | 6 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | 16 | |
| TOTALI I ZYRËS SË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM | | | | 42 | |
| Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore | | Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm | II-b | 1 | II-b |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| TOTALI | | | | 2 | |
| Drejtoria Teknike e Akcizës | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i aplikacioneve | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |
| | | Specialist | C1 | 3 | III-b |
| | Sektori i autorizimeve | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| TOTALI | | | | 8 | |
| | | | | | |
| Drejtoria e Procedurave Doganore | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i procedurave dhe regjimeve doganore | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| | Sektori i lehtësive doganore, transitit dhe informimit të operatorëve | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | 11 | |
| Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i tarifës (TARIC) | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a /1 |

ANEKSI NR. 1

| Emërtimi i postit | | | Funksioni | Kategoria | Nr. i punonjësve | Kategoria e pagës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm | | | Drejtor i Përgjithshëm | II-a | 1 | II-a |
| | | | Këshilltar për çështje teknike | A | 1 | III-a |
| | | | Drejtor kabineti | A | 1 | III-a |
| | | | Këshilltar | A | 3 | III-a |
| | | | Sekretar i drejtorit të Përgjithshëm | C3 | 1 | |
| TOTALI | | | | | 7 | |
| Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 5 | |
| Drejtoria e Auditimit të Brendshëm | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | | Auditues | C1 | 7 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 8 | |
| Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | | Specialist | C1 | 5 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 6 | |
| Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës | Sektori i planifikim-monitorim buxheti | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | Sektori i financë/kontabilitetit | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | | | Magazinier | D1 | 2 | |
| | Sektori i pagesave, garancive dhe kontabilitetit të të ardhurave | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 6 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 16 | |
| TOTALI I ZYRËS SË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM | | | | | 42 | |
| Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore | | | Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm | II-b | 1 | II-b |
| | | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| TOTALI | | | | | 2 | |
| Drejtoria Teknike e Akcizës | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i aplikacioneve | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 3 | III-b |
| | Sektori i autorizimeve | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| TOTALI | | | | | 8 | |
| | | | | | | |
| Drejtoria e Procedurave Doganore | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i procedurave dhe regjimeve doganore | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| | Sektori i lehtësive doganore, transitit dhe informimit të operatorëve | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 11 | |
| Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i tarifës (TARIC) | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |

Faqe | 13

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| | Sektori i origjinës | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 3 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 10 | |
| Drejtoria e Laboratorit Doganor | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Administratë | | Sanitar/punonjës pastrimi | D3 | 1 | |
| | | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| | Sektori i standardeve, metodikave dhe administrimit | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | Sektori i klasifikimit tarifor | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 3 | III-b |
| | Sektori i analizave | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 3 | III-b |
| | | | Asistentë | C2 | 6 | IV-a |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 20 | |
| Drejtoria e Vlerësimit në Qendër | | | Drejtor Drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i vlerës në qendër | | Përgjegjës Sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Përgjegjës Turni | C1 | 3 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 35 | IV-a |
| | Sektori i metodikave të vlerësimit doganor | | Përgjegjës Sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 43 | |
| Totali i Departamenti Teknik të Akcizës dhe Procedurave Doganore | | | | | 94 | |
| Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit | | | Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm | II-b | 1 | II-b |
| | | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| Totali | | | | | 2 | |
| Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i Monitorimit të të Ardhurave, Analizave dhe Statistikës | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 3 | III-b |
| | Sektori i Monitorimit të Borxhit | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 8 | |
| Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori) | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i Metodikave të Kontrollit | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | Sektori i Prodhkteve të Cigareve dhe Pijeve Alkoolike | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 7 | III-b |
| | Sektori i Produkteve Energjetike | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| | | | Specialist GFI | C2 | 5 | IV-a |
| | Sektori i Produkteve të Tjera | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| | Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Regjimeve Doganore | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 6 | III-b |
| | Sektori i Pajisjeve, Matëseve dhe Linjave Teknologjike | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 39 | |
| Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 3 | III-b |
| | Sektori i të Dhënave të Disponueshme | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 8 | |
| Totali i Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit | | | | | 57 | |
| Departamenti Operativo-Hetimor | | | Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm | II-b | 1 | II-b |
| | | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| TOTALI | | | | | 2 | |
| Drejtoria e Antikontrabandës | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | Sektori i Antikontrabandës Tokësore | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Komandantë grupi | C1 | 18 | III-b |
| | | | Inspektor antikontrabande | C2 | 32 | IV-a |
| | | | Doganier pike kontrolli | C3 | 8 | |
| | Sektori i Koordinimit dhe Operativitetit në Terren | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | Sektori i Antikontrabandës Detare | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Komandant grupi | C1 | 4 | III-b |
| | | | Specialist | C1 | 1 | III-b |
| | | | Specialist i gendërës | C1 | 5 | III-b |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Teknik mirëmbajtjeje | D1 | 1 | |
| | | | Teknik Mirëmbajtjeje (oficina) | D1 | 2 | |
| | | | Shofer | D1 | 8 | |
| | | | Sanitar/punonjës pastrimi | D3 | 4 | |
| | Sektori i prokurimit | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | Sektori i zgjidhjeve dhe suportit (*Help Desk*) | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 5 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 30 | |
| Drejtoria Juridike | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | III-a |
| | | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| | Sektori Teknik | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | Sektori i Legjislacionit | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| | Sektori i Ankimimeve | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 7 | III-b |
| TOTALI I DREJTORISË | | | | | 18 | |
| Totali i Departamentit Administrativ | | | | | 64 | |
| TOTALI, DREJTORIA E PËRGJITHSHME | | | | | 464 | |
| Dega Doganore Shkodër | | | Kryetar dogane | A | 1 | III-a |
| | | | Specialist/koordinator DPD | C1 | 1 | III-b |
| | Sektori i Administratës dhe Shërbimit | | Përgjegjës i administratës dhe i shërbimit | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 1 | III-b |
| | | | Financier | C1 | 1 | III-b |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Sektori i mbikëqyrjes doganore | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 5 | IV-a |
| | Sektori i operacioneve doganore | Zyra Doganore Shkodër | **Përgjegjës sektori** | B | 1 | III-b |
| | | | **Përgjegjës zyre/turni Shkodër** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 1 | |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| | | Zyra Doganore Hani i Hotit | **Përgjegjës zyre i Hani Hotit** | C1 | 3 | III-b |
| | | | Doganier peshore/pike kontrolli | C3 | 4 | |
| | | | Doganier | C2 | 6 | IV-a |
| | | Zyra Doganore Bajzë/Tuz | **Përgjegjës zyre Bajzë/Tuz** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| | | Zyra Doganore Murriqan | **Përgjegjës zyre (Murriqan)** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C2 | 4 | IV-a |
| | | | Doganier | C2 | 4 | IV-a |
| | | Zyra Doganore Vermosh | **Përgjegjës zyre (Vermosh)** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| | | Zyra Doganore Grabon | **Përgjegjës zyre Grabon** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| Totali, Dega Doganore Shkodër | | | | | 49 | |
| Dega Doganore Lezhë | | | Kryetar dogane | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 1 | III-b |
| | Zyra e Administratës | | Specialist | C1 | 1 | III-b |
| | | | Financier | C1 | 1 | III-b |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| Totali i Degës Doganore Lezhë | | | | | 15 | |
| Dega Doganore Bllate (Peshkopi) | | | Kryetar dogane | B | 1 | III-a/1 |
| | Zyra e Administratës | | Specialist | C1 | 1 | III-b |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Financier | C1 | 1 | III-b |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier peshoreje/pike Kontrolli | C3 | 3 | |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-a |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| Totali, Dega Doganore Peshkopi | | | | | 14 | |
| Dogana Doganore Kukës (Morinë) | | | **Kryetar dogane** | A | 1 | III-a |
| | | | Specialist /Koordinator DPD | C1 | 1 | III-b |
| | Sektori i Administratës dhe Shërbimit | | **Përgjegjës sektori i administratës dhe shërbimit** | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 1 | III-b |
| | | | Financier | C1 | 1 | III-b |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Sektori i Mbikëqyrjes Doganore | | **Përgjegjës sektori** | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| | Sektori i Operacioneve Doganore | | **Përgjegjës sektori** | B | 1 | III-a/1 |
| | | Zyra Doganore Morinë | **Përgjegjës zyre Morinë** | C1 | 3 | III-b |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 6 | |
| | | | Doganier | C2 | 6 | IV-a |
| | | Zyra e Skanerit | **Zyra e skanerit** | | | |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-a |
| | | Zyra Doganore Qafë-Prush | **Përgjegjës Zyre Qafë-Prush** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-a |
| | | | Doganier Peshoreje/Pike Kontrolli | C3 | 2 | |
| | | Zyra Doganore Shishtavec | **Përgjegjës zyre Shishtavec** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-a |
| | | | Doganier peshoreje/pike Kontrolli | C3 | 2 | |
| | | Zyra Doganore Qafë-Morinë, Tropojë | **Përgjegjës zyre Qafë-Morinë, Tropojë** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-a |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| Totali i Degës Doganore Kukës Morinë | | | | | 46 | |
| Dega Doganore Tiranë | | | Kryetar Dogane | A | 1 | III-a |
| | | | Specialist/koordinator DPD | C1 | 1 | III-b |
| | Sektori i Administratës dhe Shërbimit | | **Përgjegjës sektori i administratës dhe shërbimit ndaj tatimpaguesit** | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | III-b |
| | | | Financier | C1 | 1 | III-b |
| | | | Specialist i nivelit të dytë | C2 | 1 | IV-a |
| | | | Sekretar | C3 | 1 | |
| | | | Arkivist | C3 | 2 | |
| | | | Magazinier | D1 | 1 | |
| | Sektori i Mbikëqyrjes Doganore | | **Përgjegjës sektori** | B | 1 | III-a/1 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 22 | IV-a |
| | Sektori i Operacioneve Doganore | | **Përgjegjës i sektorit të operacioneve doganore** | B | 1 | III-a/1 |
| | | Zyra e Pikës së Hyrjes/Daljes | **Përgjegjës zyre peshore/pike kontrolli** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 8 | |
| | | Zyra Doganore Tiranë | **Përgjegjës zyre operacionet doganore** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 12 | IV-a |
| | | Zyra e Magazinimit të Përkohshëm | **Përgjegjës zyre** | C1 | 1 | III-b |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-a |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |

Shëndetësi

Në rastet kur fëmijët kanë temperaturë të lartë, rekomandohet që mos të shkohet direkt në spital. Ata mund të marrin një thelb hudhër, ta shtypin që t'i marrin lëngun e ta përziejnë me pak sodë buke e pak mjaltë e t'i lyejnë fëmijës bajamet. **Nëse nuk e realizojnë dot këtu, t'i përgatisin një çaj me trëndafilin e egër, lulen e shtogut, pak lëvore shelgu apo limoni dhe aguliçë apo peta të arrës.**

Mjeku popullor: Simptomat e viruseve, parandalimi me bimë mjekësore e çajëra

# YLLI MERJA: Si të luftoni gripin me propolis e hudhër

## "Masat për të ulur menjëherë temperaturën"

Voltiza Duro

Mjeku popullor Ylli Merja

Ndodhemi në 3-jav ëshin e parë të se zonit të dimrit, e po përballemi me uljen e temperaturave në ambientet e jashtme dhe mbajtjen në vlera të larta të temperaturës në shtëpi. Pikërisht këto ndryshime temperaturash pëlqen edhe virusi i gripit, qoftë ai A, B apo C. Më të shpeshtit janë virusi A dhe B që përhapen me rrugë ajrore nga njëri person te tjetri nëpërmjet teshtimave, prekjes së objekteve të përbashkëta, ose kollitja në ambientet publike. Këto janë mënyrat e përhapjes së gripit që me rrugët aspiratore hundë apo gojë, arrijnë në brendësi të alveolave të mushkërive, më pas hyjnë në kombinacion me to. Mbështjellja proteinike e viruseve, ngjiten në alveolën e mushkërive, hyjnë në bashkëpunim me qelizën e fillojnë ta shkatërrojnë. Kjo periudhë inkubacioni që zgjat 24-72 orë shoqërohet me çrregullime fiziologjike, këputje trupore, rrjedhje hundësh, skuqje sysh etj. ky është momenti që njeriu duhet të kuptojë që virusi është i pranishëm në trupin e tij dhe pas 1-2 ditësh bëhet si një burim amplifikacioni e përhapet edhe te të tjerët. Ndërsa në trupin e të sëmurit fillon ajo "lufta" e brendshme fiziologjike e organizmit e i gjithë ky cikël zgjat 5, 7 apo 10 ditë. Por, nëse marrim masa mbrojtëse, ky cikël do të shkurtohet e shkalla e agresivitetit të virusit do të bjerë.

**PARANDALIMI**

Zgjidhja për parandalimin e gripit, ndodhet në kuzhinën tonë. Nëse njeriu konsumon 2-3 thelpinj hudhër në ditë, të shoqëruara me një gotë ujë, mund ta parandalojë më së miri prekjen nga virusi, ndërsa në moshat e vogla, përdoret 1 thelb hudhër në ditë. Vrasësit e këtyre viruseve janë rigoni e trumza, që përmbajnë disa elemente antibakteriale e antimykotike. Këto bimë mund t'i përdorim në gjellë apo në çaj e për fëmijët e vegjël gjysmë lugë kafeje me rigon është më se e mjaftueshme. Për të pasur epërsi ndaj virusit që mund të jetë zhvilluar e lufton leukocitet për të shumëzuar vetveten, mund të përdorim çaj me piper të zi, petat e arrës, karafil e kanellë. Kjo përzierje rrit rezistencën e organizmit dhe shton fuqinë goditëse ndaj viruseve. Por më i fuqishmi është propolisi antimykotik, i cili nuk lejon inflamacion bajamesh, laringite dhe acarim të mushkërive. Në të kundërt rekomandojmë që në pak çaj apo ujë, të hedhim pak propolis për të minimizuar shijen paksa të hidhur. Ndërsa kur hasim vështirësi në frymëmarrje e bllokim hundësh te fëmijët, rekomandohet që të merret vaj dafine, e t'i vendoset te hunda, t'i hidhet një pikë në gojë e 2-3 pika në gjoks. Brenda 2 minutash rrugët respiratore do të jenë totalisht të zhbllokuara. Gjithashtu, duhet të përdoren shumë lëngje frutash, veçanërisht ai i limonit.

**TEMPERATURA E LARTË**

Në rastet kur fëmijët kanë temperaturë të lartë, rekomandohet që mos të shkohet direkt në spital. Ata mund të marrin një thelb hudhër, ta shtypin që t'i marrin lëngun e ta përziejnë me pak sodë buke e pak mjaltë e t'i lyejnë fëmijës bajamet. Nëse nuk e realizojnë dot këtu, t'i përgatisin një çaj me trëndafilin e egër, lulen e shtogut, pak lëvore shelgu apo limoni dhe aguliçë apo peta të arrës. Pas kësaj i hedhim dhe 10 pika propolis, e ia japim fëmijës vazhdimisht duke e masazhuar me pak raki rrushi ku ke hedhur 1 apo 2 paracetamolë. Ky masazhim duhet të bëhet jo shumë afër reflektorit, e më pas ta mbështjellim mirë e t'i fshijmë djersët. Pas kësaj temperatura do të bjerë. Në rastet e fëmijëve alergjikë, duhet të kontrolloni gjuhën nëse ka myk apo bajamet mos janë të qelbëzuara. Nëse i pastrojmë gjuhën me sodë e hudhër, e trajtojmë me propolis e i japim pak çaj me disa bimë si trëndafil i egër, piper i zi, vaj dafine për të marrë rezultate të menjëhershme. Fëmijës në këto raste i është ulur rezistenca e duhet patjetër që të merret me aktivitet fizik. Për uljen e temperaturës së lartë mund të përdoret edhe propolisi si dhe kompresat e ftohta me uthull molle në ballë, pasi kjo e fundit ka efekt të menjëhershëm. Por nuk duhet të mjaftohemi me kaq, sepse duhet të marrë edhe vitaminën C nëpërmjet bimëve të ndryshme si çaj trëndafili, çaj mali, boronica etj. Ndërsa në rastet kur njeriu vuan nga bronkiti apo ndonjë inflamacion i mushkërive, duhet të përdoret dafinë dhe çaj mente për të eliminuar fillimisht mukozën e thatë dhe gërhitjen.

"Bonus 2.5 milionë lekë të vjetër për mjekët që mbulojnë spitalet rajonale"

# Portali, hapen 420 vende të lira pune për infermierët

## *Edi Rama: U japim fund punësimeve politike*

Voltiza Duro

Plot 420 vende rezultojnë të lira për të gjithë infermierët që ende nuk kanë arritur të gjejnë një punë, por që tashmë do të kenë mundësinë të aplikojnë nëpërmjet portalit. Ky lajm është bërë me dije, ditën e djeshme, nga kryeministri i vendit, Edi Rama gjatë prezantimit të portalit të punësimit të infermierëve, teknikëve të imazherisë, fizioterapistëve, logopedëve e mamive. Kreu i ekzekutivit theksoi ndër të tjera se portali do të bëhet ligj e do të kthehet në normë ligjore për të filluar kështu një histori të re në infermierinë shqiptare. "Portali do të bëhet ligj. Janë disa mijëra që duan të futen në punë dhe nuk ka disa mijëra vende pune, janë 420 sot vende vakante, por me këtë grup të parë fillon një histori e re në infermierinë shqiptare, sepse çdo vend që do të hapet kur një të dalë në pension apo që do largohet për të shkuar diku tjetër do të mbushet nga ai që pret në radhë dhe nga ai që ka pikët e mjaftueshme për të qenë i pari i radhës që të plotësojë vendin vakant",-u shpreh kryeministri. Ky i fundit shtoi se nëpërmjet punësimit me portal nuk do të ketë më lëvizje politike nga vendet e punës. E pranishme në këtë takim, ishte edhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila nënvizoi se synimi bazë i krijimit të një sistemi të tillë është përzgjedhja e fituesve sipas meritokracisë. "Ne kemi detyrim të krijojmë një terren të njëjtë për të gjithë, të japim shanse të barabarta dhe të krijojmë drejtësi në punësim. Aplikoni dhe vini veten në provë. Ne ju garantojmë që do të zgjidhen më të aftët. Platforma do të ndryshojë mënyrën se si bëhet punësimi i infermierëve dhe profesionistëve. Për ne është një reformë që garanton cilësi në shërbime, transparencë, eliminon punësimin prej mikut dhe i jep fund emërimeve pa plotësuar asnjë kriter", tha Manastirliu. Ndërkaq, aplikimi në portal do të bëhet në bazë qarku, në një kohë që kandidatët do të njoftohen hap pas hapi për statusin e aplikimit të tyre dhe mbi vendin e datën e testimit të njohurive të tyre.

**MJEKËT RAJONALË**

Gjatë prezantimit të portalit, kryeministri Edi Rama diskutoi edhe mbi projektin për mbulimin e spitaleve të rretheve me mjekë specialistë, të cilët do të marrin një bonus mbi pagën me vlerë 2.5 milionë lekë të vjetra. "2.5 milionë lekë të vjetra plus rrogës. Ju duken shumë, por është edhe më e madhe kostoja nga mungesa e tyre. Për mjekët që do të shkojnë në Tropojë, Librazhd, etj; të mund të ketë një fitim real. Është një migrim i brendshëm, një fitim që nuk do ta kishte po të emigronte jashtë vendit",-u shpreh Rama. Ky i fundit tha, gjithashtu, se në spitalet rajonale ka më pak se 100 mungesa të mjekëve specialistë, çka shkakton një boshllëk të konsiderueshëm për shërbimin mjekësor në vend.

**OGERTA MANASTIRLIU**

**GARANTOHET TRANSPARENCË**

"Aplikoni dhe vini veten në provë. Ne ju garantojmë që do të zgjidhen më të aftët. Platforma do të ndryshojë mënyrën se si bëhet punësimi i infermierëve dhe profesionistëve. Për ne është një reformë që garanton cilësi në shërbime, transparencë, eliminon punësimin prej mikut dhe i jep fund emërimeve pa plotësuar asnjë kriter", - tha Manastirliu.



## Veliaj: 2018, vit më i mirë për Tiranën

### Mbillen 200 pemë të reja te Liqeni i Thatë

Në zonën e digës së Liqenit të Thatë janë mbjellë 200 pemë të reja, në kuadër të aksionit të Bashkisë së Tiranës që synon mbjelljen e 100 mijë pemëve në kryeqytet. Nisma "një qytetar, një pemë" është vënë në jetë prej disa kohësh, e ka si qëllim edhe sensibilizimin e qytetarëve, por edhe bizneseve për një qytet më të gjelbër e të pastër. I pranishëm në mbjelljen e 200 pemëve të reja, ishte dhe kryebashkiaku Erion Veliaj, i cili ftoi gjithë qytetarët që t'i dhurojnë kryeqytetit një pemë. "Do doja të ftoja të gjithë qytetarët e Tiranës, nëse mund të merrni një zotim, kush është i rritur në Tiranë, sikur të mbjellë 1 pemë gjatë vitit 2018, automatikisht i ka dhënë Tiranës gjysmë milionë pemë",-u shpreh Veliaj. Ky i fundit foli i kënaqur për ecurinë e deritanishme të këtij projekti, ndërsa shprehu mirënjohje për të gjitha sipërmarrjet që i janë bashkuar Bashkisë së Tiranës në këtë nismë të sajën. Veliaj është shprehur optimist se viti 2018 do jetë për Tiranës akoma më i mirë se viti që po lëmë pas.

## Nis aksioni për kontrollin e qumështit

Ka nisur aksioni për kontrollin e përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, bazuar në plotësimin e standardeve të sigurisë ushqimore. Kjo është bërë me dije gjatë takimit të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peleshi me fermerët e zonës së Fierit. "Do të disiplinojmë një produkt shumë të rëndësishëm, të përditshëm ushqimor, që është qumështi dhe nënproduktet e tij, në një kohë të shpejtë, duke kërkuar mbështetje dhe mirëkuptim nga të gjithë. Dhimbja e këtyre lloj reformave bëhet shumë e vogël, në qoftë se, secili vepron, investon, mundohet që të arrijë standardin, që ligji i kërkon, në kohë, pa marrë, po themi ndëshkimin, apo sanksionet ligjore",-citoi ministri. Ndërkaq, ky i fundit ka bërë publike skemën mbështetëse për përmirësimin e zinxhirit të sigurisë ushqimore të produkteve blegtorale, duke dhënë shifra dhe vlera konkrete të subvencionimit dhe financimit në lekë të blegtorëve shqiptarë.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,120,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërhequja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë**"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Shkurt 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje dhe implementim i disa pajisjeve servera dhe shasi për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 44,000,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërhequja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC
Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje dhe implementim i disa pajisjeve servera dhe shasi për nevojat e Bankës së Shqipërisë**".

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 01 Shkurt 2018, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Studimi i ASHR-së për Tiranën: Fëmijët kanë shfaqur edhe probleme të theksuara të shikimit

# Alarmi, 1 në 10 fëmijë hanë vetëm një vakt në ditë

## *Ekspertët: Shifrat e frikshme, Kamza, zona më e kequshqyer*

Shifrat alarmante pas një vëzhgimi në shkollat fillore të kryeqytetit tregojnë se 1 në 10 fëmijë jeton vetëm me një vakt në ditë e një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të kequshqyer. Këto të dhëna vijnë pas intervistave të realizuara nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë me 800 fëmijë të vegjël, ku 80 prej tyre pohuan se hanë vetëm një herë në ditë. Ky studim shkencor ka përfshirë plot 15 shkolla fillore të kryeqytetit dhe rrethinat, ku situata më e rëndë paraqitet në shkollën "100-Vjetori" në Kamëz, pasi niveli ekonomik i familjeve është i ulët e për pasojë edhe vogëlushët e kësaj zone janë më të kequshqyerit, nën peshë dhe të shkurtër. E ky zhvillim fizik i mangët mesa duket është shkaktuar nga sasia e pamjaftueshme e ushqimit që marrin. Ndërsa në kryeqytet sipas ekspertëve të ASHR-së, është rritur numri i të miturve obezë si dhe janë shfaqur probleme me shikimin, që i pengon edhe në procesin e mësimnxënies. "10% e fëmijëve kanë deklaruar një vakt të konsumuar në ditë, kjo është shifër e frikshme. 2 vakte 11% e fëmijëve, 3 vakte 41% dhe 4 vakte 38% e fëmijëve. Një pjesë të kësaj statistike e shton më shumë zona e Kamzës, shkolla '100-Vjetori' që kemi studiuar. Ne jemi rikthyer për të vërtetuar saktësinë e informacionit, ku u deklarua edhe nga vetë mësuesit e drejtori i shkollës se janë shifra shumë reale, sepse shumica e fëmijëve janë me ndihmë ekonomike dhe vërtet paraqitet një nivel i tillë", - u shpreh eksperti i Autoritetit Shëndetësor Rajonal për Tiranën. Ndërkaq, ai më tej theksoi se në zonat rurale janë konstatuar 19% e fëmijëve nën peshë si pasojë e kequshqyerjes, ndërsa 9% rezultojnë mbi peshë dhe 4% e tyre janë obezë. Ndërkohë, në zonat urbane 4% e fëmijëve paraqiten nën peshë, në peshë normale 70%, mbi peshë 15% e të miturve dhe obezë rezultojnë 11% e të miturve. Synimi i këtij studimi shkencor në 15 shkollat e kryeqytetit, sipas ekspertëve të ASHR-së është evidentimi i hershëm i problematikave më kryesore të shëndetit tek kjo grupmoshë. Më tej, është theksuar se 3-4% e fëmijëve që janë marrë në vëzhgim kanë probleme të theksuara të shikimit. I njëjti studim nxjerr në pah lirinë e tepruar dhe mungesën e kujdesit prindëror ndaj fëmijëve në aksesin ndaj kompjuterit dhe televizionit, ku 1 e katërta e tyre thonë se shikojnë të vetëm televizor në dhomën e tyre. Shifrat e frikshme duhet të jenë një kambanë alarmi për prindërit, por edhe për institucionet që kanë të drejtë të ndërhyjnë për të ofruar një përmirësim të situatës nëpërmjet programeve e masave specifike në të mirë të shëndetit të fëmijëve.

Fotot ilustruese

**STUDIMI**
"10% e fëmijëve kanë deklaruar një vakt të konsumuar në ditë, kjo është shifër e frikshme. 2 vakte 11% e fëmijëve, 3 vakte 41% dhe 4 vakte 38% e fëmijëve. Një pjesë të kësaj statistike e shton më shumë zona e Kamzës, shkolla '100-Vjetori' që kemi studiuar", - tha eksperti.

**ZONAT RURALE**
Në zonat rurale janë konstatuar 19% e fëmijëve nën peshë si pasojë e kequshqyerjes, ndërsa 9% rezultojnë mbi peshë dhe 4% e tyre janë obezë. Ndërkohë, në zonat urbane 4% e fëmijëve paraqiten nën peshë, në peshë normale 70%, mbi peshë 15% e të miturve dhe obezë rezultojnë 11% e të miturve.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR

Në zbatim të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 184, neni 8, datë 17.03.2010, Komisioni i Prokurimit Publik shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat: Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinjer elektronik/informatik; inxhinjer mekanik; inxhinjer hidrologjik; inxhinjer elektrik; inxhinjer gjeologji-minierash; inxhinjer mjedisi; inxhinjer ndërtimi; inxhinjer tekstile; kimist; specialist në farmaceutikë.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat :
1.Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2.Të ketë licensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e expertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapagim nga pala ankimuese.

Kandidati duhet të paraqesë **brenda datës 09 Shkurt 2018** në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të lincensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, fotokopje te kartës së identitetit, një numër telefoni për t'u kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.


**MASR: Ndryshim i nevojshëm për efikasitetin e mësimnxënies**

## Prej 1 shkurtit ndryshon kalendari mësimor, ja sa lëndë do të zhvillohen në ditë

Prej datës 1 shkurt të këtij viti, nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në mbarë vendin do të zhvillojnë vetëm 3 lëndë mësimore në ditë. Kjo në kuadër të nismës së Ministrisë së Arsimit, e cila shprehet se ky është një ndryshim i nevojshëm në përmirësimin e efektivitetit të procesit të të nxënit të nxënësve. Projekti që do të vihet në jetë së shpejti, e njohur si "3 lëndë në 6 orë", parashikon ndryshimin e kalendarit mësimor në sistemin parauniversitar. Respektivisht, brenda një dite do të zhvillohen vetëm 3 lëndë që do të zgjasin 90 minuta secila, nga 45 që ishin me metodën tradicionale të mësimdhënies. Nga ky reformim do të krijohet mundësia e lehtësimit të peshës së çantave të nxënësve, çka është ngritur shpeshherë si problem nga prindërit. Kjo ide erdhi nga një grup mësuesish, nxënësish e prindërish, të cilët ia bënë me dije nismën MASR në platformën për bashkëqeverisjen qytetare. Në një komunikim interaktiv me këtë grup nismëtar, kryeministri Edi Rama tha se ky është një realitet i ri, që po përpiqen të krijojnë në Shqipëri. "Patëm një rast konkret me një grup naftëtarësh në zonën e Fierit që morën rrugën për të ardhur në Tiranë. Përpara se të vihet këtu, fare mirë, nëpërmjet platformës mund të kërkohej interpelancë këtu, me ministrin e Energjisë. Duam që të vihemi në provë. Njerëzit janë zhgënjyer kaq shumë në vite nga indiferenca e politikës, sa me të drejtë mund të thonë që këto të gjitha janë filma. Ky është një realitet i ri që po mundohemi të krijojmë", -tha kryeministri Rama.

Ministria e Arsimit

**NISMA E MASR**
Projekti që do të vihet në jetë së shpejti, e njohur si "3 lëndë në 6 orë", parashikon ndryshimin e kalendarit mësimor në sistemin parauniversitar.

**KALENDARI MËSIMOR**

Në bazë të këtij ndryshimi, shkolla mund të riorganizojë orët mësimore të lëndëve, duke zhvilluar për një lëndë, 2 (dy) orë mësimore të njëpasnjëshme (45 + 45), sigurisht me pushimin 5-minutësh ndërmjet tyre. Kjo do të thotë që nxënësi mund të zhvillojë në një ditë 3 lëndë të ndryshme dhe jo 6 lëndë të ndryshme. Zhvillimi i lëndëve mësimore në dy orë të njëpasnjëshme brenda një dite është një praktikë që zbatohet edhe në vendet e tjera. Qëllimi i kurrikulës, sipas MAS është që të ndërtojë dhe të zhvillojë kompetenca te nxënësit. Kjo do të thotë që gjatë orës së mësimit të përdoren metoda, teknika dhe strategji, të cilat do t'u mundësojnë nxënësve që të ndërtojnë vetë dijet dhe njohuritë e tyre.

SHKRIMTARI PËR GRUAN: ËSHTË FTOHTË, PO TË ISHTE SADIJA IME, NUK DO TË MBRETËRONTE KJO GJENDJE

# DALIN LETRAT PAS DASME

## Dritëroi, Sadijes: Dimri, i vështirë për dashnorët

Fatmira Nikolli

Data 6 janar 1965 shënon ditën e celebrimit të Dritëro Agollit me të shoqen, Sadijen. Kanë qenë ditë të ftohta janari, por plot pasion, aq bukur të përshkruara në letërkëmbimin mes tyre shkruan e bija, Elona, teksa publikon disa nga letrat që shkrimtari i ka shkruar të shoqes në vitin 1965. Letrat do të jenë pjesë e një botimi me rastin e 1-vjetorit të ndarjes nga jeta të shkrimtarit në shkurt.

### LETRA E PARË

"E dashur Sadije,

U ktheve në shtëpi e lodhur, po me fitore. U bëre zyrtarisht gruaja ime. S'ka tani tërc mërc. Emrin tim e ke edhe në pasaportë. Bëjmë shaka, se s'ka ndonjë rëndësi një vulë e thatë. Ne edhe sikur të mos e kishim atë vulë, prapë bashkë do të ishim.

Ceremonia u hap me fjalën e z Eridana Çano, Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Sezoni i parë i 2018-s sjell risi, i organizon veprimtaritë e COD në disa linja konkrete e komplekse dhe i bën ndërvepruese hapësirat, gjithnjë duke pasur qytetarin në qendër. Në vijim, kuratori Genti Gjikola prezantoi punën e artistes, e cila ekspozon për herë të parë për publikun shqiptar. Sipas tij, "thuajse në të gjitha veprat që shihen në këtë ekspozitë, duket se ka shpresë që me anë të një përpjekjeje të

udhëtimi në vende të largëta ku qielli është i kuq dhe valët e detit janë të zeza si bitum, me ombrellë në dorë, njeriu bashkëkohor do të gjejë shpëtim". Më pas, Mia Enell foli për artin e saj, gjuhën e tij dhe komunikimin me publikun. "Nuk dua që puna ime të ketë të bëjë vetëm me një gjë. Nëse vepra kërkon qëllimisht të mos bjerë në sy dhe ka një fill humori, mundet që ajo të hedhë dritë mbi çështje madhore veçantë, një "ndërrimi të lëkurës" një propozimi me "ide të mira", ardhjes së një zarfi misterioz, një

dhe jo thjesht një ide",-u shpreh Enell. "Gjithnjë jam munduar ta mbaj veprën time të hapur. Ke mundësi të bësh një zgjedhje, të përqendrohesh dhe ta mbyllësh punën, ose ta mbash të hapur atë. Unë zgjedh ta mbaj të hapur". Krijimtaria e Enell dhe veprat e prezantuara në Shqipëri janë pjesë e katalogut "Tani tani tani", i mundësuar për vizitorët e ekspozitës. Ekspozita do të jetë e hapur për publikun deri më 9 mars 2018. Mia Enell lindi më 1967 në Goteborg të Suedisë. Aktualisht jeton dhe punon në Nju Jork, SHBA.

Enell përfundoi Shkollën e Artit Nyckelvikskolan në Stokholm (1987) dhe më pas Shkollën e Lartë Kombëtare të Arteve të Bukura në Paris, DNSAP (MFA), (1992). Punët e saj janë prezantuar në shumë ekspozita kolektive e vetjake, në muze e galeri të rëndësishme në Shtetet e Bashkuara dhe Europë. Veprat e Mia Enell gjenden në koleksione të mëdha ndërkombëtare dhe private, përfshirë L.A.C.M.A., Muzeun e Arteve në Los Anxheles; Koleksionin Borghese, Itali, Koleksionin Ahrenberg, Zvicër; Statens Konstråd - Agjencia Kombëtare e Artit Publik, Suedi; Fondin e Depozitave e Investimeve dhe FNAC - Fondin Kombëtar të Artit Bashkëkohor në Paris, Francë.

Deputeti Karemani: Më kanë kërcënuar me jetë mua dhe familjen time

# Shkup, vijojnë përçarjet brenda lëvizjes "Besa"

## *Ish-kryetari i "Besës" takon Zoran Zaev*

Vijon kriza politike në partinë opozitare "Besa" në Maqedoni, ndërsa po shtohen mosmarrëveshjet dhe ndasitë brenda strukturave të saj udhëheqëse. Drejtuesit e partisë mohojnë se deputetët e saj janë të ndarë në dy grupe, njëri me degën e Tetovës e afërt me Bilall Kasamin dhe tjetri me degën e Shkupit, kundër tij. Zoti Kasami, megjithatë, tha të martën se të gjithë deputetët e "Besës", që janë gjithsej pesë, janë të bashkuar dhe veprojnë të bashkuar në parlament. Nga ana tjetër, deputeti Nexhmedin Karemani, i cili zuri vendin e Bilall Kasamit në parlament, është ankuar se ka pasur kërcënime me jetë ndaj tij dhe familjes së tij. Zoti Karemani u tha gazetarëve të martën se i njihte kërcënuesit dhe se motivet e tyre ishin politike, se i kishin kërkuar të dorëhiqej nga posti i ushtruesit të detyrës së kryetarit të partisë që e mori kohët e fundit dhe nga posti i deputetit. Ai tha se kishte njoftuar për kërcënimet autoritetet policore dhe vetë ministrin e brendshëm Oliver Spasovski. Nexhmedin Karemani u bë ligjvënës duke zënë vendin e Bilall Kasamit pasi ky pati dhënë dorëheqjen gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale në muajin Tetor, kur u kandidua për kryetar të komunës së Tetovës. Zoti Kasami pati dhënë dorëheqjen edhe nga posti i kryetarit të partisë pasi Lëvizja "Besa" shënoi rezultate të dobëta në këto zgjedhje, por burime të afërta me të nuk e përjashtojnë mundësinë që ai të rikandidohet për postin e kryetarit të partisë në kongresin e caktuar për në muajin shkurt. Zoti Kasami shkoi të martën në mbrëmje në zyrat e kryeministrit maqedonas Zoran Zaev, por ende nuk janë mësuar hollësitë e takimit mes tyre. Ndërkaq, burime qeveritare i kane thënë agjencisë shtetërore të lajmeve "Mia" se në takim është biseduar për paketën e reformave të ligjeve në parlament. Besohet se deputetët Fadil Zendeli dhe Teuta Bilalli janë me "krahun e Tetovës" duke u nisur edhe nga paraqitjet këto ditë të eksponentëve partiakë para medias që shihen pranë zotit Bilalli për dallim nga kolegët e tyre të tjerë, Afrim Gashi, Nexhmedin Karemani dhe Rexhep Memedi, të cilët qëndrojnë pranë fraksionit tjetër. Dy grupet kanë mosmarrëveshje edhe me selinë e partisë në Shkup. Herë njëri e herë grupi tjetër hyjnë në hapësirat e selisë duke hapur forcërisht dyert dhe duke akuzuar njëri-tjetrin për tentativë uzurpimi, por edhe duke alarmuar policinë për veprimet e fraksionit të kundërt. Partitë e tjera në Maqedoni nuk kanë komentuar publikisht mbi zhvillimet brenda Lëvizjes "Besa".

**PËRÇARJA**
Dy grupacionet më të fuqishme në parti, ai i Shkupit dhe i Tetovës, kohët e fundit kanë shpërfaqur rivalitetet e tyre për marrjen e timonit të partisë. Dy grupet kanë mosmarrëveshje dhe hyjnë në hapësirat e selisë duke hapur forcërisht dyert.

Ndërkaq, ka spekulime në një pjesë të medias në Shkup se njëri ose krahu tjetër i saj mund të bëhet pjesë e koalicionit qeveritar, apo të mbështetësë politikat qeveritare edhe pa qenë zyrtarisht pjesë e pushtetit. Lëvizja "Besa" është një parti e re në skenën politike të Maqedonisë dhe ajo për herë të parë mori pjesë në zgjedhjet parlamentare në dhjetor të vitit 2016, duke fituar pesë poste ligjvënësish që e bëri atë partinë e dytë më të madhe shqiptare, pas Bashkimit Demokratik për Integrim. Por, ndikimi i saj ra shumë shpejtë, vetëm pas dhjetë muajsh: "Besa" fitoi vetëm një kryetar komune në zgjedhjet vendore të 15 tetorit, atë të Zhelinës pranë Tetovës. Partia e vlerësuar si financiarisht e fuqishme, i ka hedhur poshtë akuzat e kundërshtarëve dhe shtypit për lidhshmëritë me donatorë turq apo nga vende islamike, ndërkohë që drejtuesit partiakë kanë përsëritur se janë transparentë lidhur me të dhënat financiare dhe nuk fshihen nga organet hetuese maqedonase.

## E ÇUDITSHME! BIE BORË NË SAHARA

**E çuditshme, por e vërtetë, kjo foto sjell pasqyrimin e dëborës në Shkretëtirën e Saharës pasi një stuhi goditi Algjerinë. Pamjet e jashtëzakonshme shfaqin qytetin-shkretëtirë të Ain Sefra të mbuluar me borë të papritur që shkon në disa centimetra thellësi, raporton "The Sun". Është hera e tretë që ky qytet mbulohet nga batanija e bardhë në 38 vjetët e fundit. Janarin e kaluar ky territor, që është shkretëtira më e nxehtë, u mbulua nga bora që arriti trashësinë 1 metër ndërsa flluska bore pati edhe në dhjetorin e vitit 2016. Para kësaj, Ain Sefra nuk kishte parë borë që nga 18 shkurti i vitit 1979, kur pati të reshura që zgjatën vetëm 30 minuta. Bora kësaj radhe nisi të binte në orët e hershme të së dielës dhe shpejt mbuloi rërën. Fotografi Karim Bouchetata tha: "U befasuam me të vërtetë kur u zgjuam dhe pamë bardh. Qëndroi gjatë gjithë ditës së diel dhe nisi të shkrihej rreth orës 5 të pasdites".**

Bilall Kasami

## 29-vjeçari e dhunon pastaj kërkon para

### I riu maqedonas i infektuar me HIV përdhunon 82-vjeçaren

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Hamburg, ku ka çuar para trupës gjykuese një të ri maqedonas për dhunën ndaj një personi të moshuar. 29-vjeçari nga Maqedonia, i infektuar me HIV, akuzohet nga një gjykatë e Hamburgut se ka përdhunuar një grua të moshuar 82-vjeçare në Hamburg. Dzengis D. këtë akt mendohet ta ketë kryer më 8 korrik të vitit të kaluar, në shtëpinë e viktimës në një lagje të qytetit, shkruan "Hamburger Abendblatt". Gruaja është përpjekur pa sukses të mbyllë derën e ballkonit, prej nga kishte hyrë sulmuesi, por pa sukses. 29-vjeçari pastaj e ka rrëzuar të moshuarën në dysheme, ia ka mbyllur gojën dhe e ka përdhunuar pesë herë. Shtetasi i Maqedonisë, i cili ka qenë i dënuar edhe më parë, akuzohet se pas përdhunimit ka kërkuar para nga plaka. Për shkak të dhunës së ushtruar, gruaja e moshuar ka pësuar në gjithë trupin lëndime të dukshme. Por për fat të mirë e moshuara nuk është infektuar me HIV. Deri tani i akuzuari Dzengis D. ka heshtur para trupit gjykues, por procesi kundër tij do të vazhdojë më 16 janar.

## Katastrofat natyrore, ja sa miliona u kushtoi SHBA-ve viti 2017

Mes uraganeve, përmbytjeve dhe zjarreve, fatura e Shteteve të Bashkuara për katastrofat natyrore në 2017 arriti në 306 miliardë dollarë. Sipas një studimi të Administratës Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike, shifra e regjistruar eklipson rekordin e mëparshëm të vendosur në vitin 2015, kur SHBA u përball me 215 miliardë dollarë dëme për shkak të katastrofave natyrore. Në krye të listës ishte uragani Harvey, që shkaktoi plot 125 miliardë dollarë dëme, i ndjekur nga uraganet Maria dhe Irma, me nga 90 dhe 80 miliardë dollarë dëme respektivisht. Vetëm në 2017, SHBA u godit nga 3 prej 5 uraganeve më të fuqishëm që vendi ka përjetuar. Edhe zjarret shkaktuan dëme, ku përllogariten 18 miliardë dollarë.

## Maqedonia nuk hyn në BE as në 2025

BE ka hartuar një itinerar të qartë për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit. Në fillim të shkurtit KE do të bëjë publike "strategjinë e zgjerimit", e cila është shpallur si "Strategji për anëtarësimin e Serbisë dhe Malit të Zi". Kjo strategji përfshin të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat gjenden në procesin e integrimit. Sipas këtij dokumenti, Mali i Zi dhe Serbia pritet të anëtarësohen në 2025, Shqipëria dhe Maqedonia do të përfitojnë nga procesi duke u afruar më afër Unionit. Sipas dokumentit, Bosnja dhe Hercegovina do të marrin statusin kandidatë në 2019, ndërsa Kosova do të përfitojë nga liberalizimi i vizave nëse i plotëson kriteret e parapara nga KE. Strategjia, gjithashtu, parasheh që vendet e rajonit t'i zgjidhin kontradiktat e hapura me fqinjët.

Dje në 'Deutsche Welle'

# Largimi i trurit, shkak ekonomia, siguria publike dhe institucionet e dobëta

Nga Ani Ruci

*(Vijon nga faqja e parë)*

... se 757 mijë banorë. Ai nuk e di nëse do të vazhdojë të punojë në bashki apo jo në vitin që po vjen, 2018. Në ditët e para të janarit ai do të merret në intervistë nga Zyra për Çështjet Konsullore në Ambasadën Amerikane në Tiranë, pasi ka fituar aplikimin në Lotarinë Amerikane për të jetuar dhe punuar legalisht në SHBA.

"Në Bashkinë e Tiranës ka hapësira të mëdha për t'u rritur profesionalisht, për të pasuruar përvojat. Puna në bashki më jep mundësi të njoh mirë problemet që kanë qytetarët dhe parë nga afër sesi funksionojnë gjërat në realitet. Të punosh në Bashkinë e Tiranës është një mundësi e shkëlqyer". thotë për 'DW', Orest Çipa.

Por ai po përpiqet ta lërë këtë mundësi, edhe pse vetë e quan të shkëlqyer, për të shkuar drejt të panjohurës, ëndrrës amerikane. I arsimuar në Universitetin e Tiranës për gazetari, ai ka kryer një master 3-vjeçar për Drejtësi dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Shangait, me përvoja të mira pune brenda dhe jashtë Shqipërisë, ka krijuar familjen e tij, është prind i një vajze të vogël. Megjithatë, ai nuk ndihet i plotësuar në Tiranë. Gotën e tij në Shqipëri e sheh gjysmë bosh.

"Ka shumë faktorë që më bënë të aplikoja për të fituar Lotarinë Amerikane dhe për u larguar nga Shqipëria. Janë faktorë ekonomikë, por edhe të tjerë, që nuk kanë të bëjnë me ekonominë. Ka një zhvillim të ngadalshëm shoqëror, emancipues, demokratizues. Psh., ndjej një rënie të peshës, fuqisë së qytetarëve që i kërkojnë llogari qeverisjes dhe duan një rol më të madh. Ende indeksi i korrupsionit është goxha i lartë, ndër më të lartët në Ballkanin Perëndimor. Këtu ndodh që edhe raportin e invaliditetit, kur je invalid, duhet ta marrësh me mik. Dihet që sa më i lartë korrupsioni, aq më e lartë përqindja e njerëzve të arsimuar që kërkojnë të largohen. Korrupsioni fiton terren në kurriz të ndërtimit të një shoqërie të bazuar në merita. Ka edhe faktorë të tjerë që lidhen me jetën e përditshme", thotë Orest Çipa.

### 'BRAIN DRAIN' - IKJA E "TRURIT" NGA SHQIPËRIA, ME PËRMASA SHQETËSUESE

Faktorët e tjerë i identifikon vetë qeveria "Rama 2". Në Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe Migracionin, 2018-2024, krahas faktorit ekonomik janë identifikuar edhe faktorë të tillë si: "niveli i ulët i sigurisë publike, mungesa e besimit të qytetarëve në përmirësimin e situatës në vend, ku korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore". Në Strategjinë Kombëtare, e përmendur më lart, vihet në dukje se fenomeni i largimit të trurit, i njohur si 'Brain Drain', i shfaqur në vitin 1990, menjëherë pas rënies së regjimit komunist, ka vazhduar edhe gjatë tranzicionit të vështirë post-komunist dhe nga viti në vit përmasat e tij janë bërë shqetësuese. Kjo pasi largimi i trurit nuk përfshin vetëm akademikët apo personat e kualifikuar të fushave të tjera. "Një numër i madh studentësh shqiptarë shkojnë në Itali dhe Greqi dhe më pas 'truri' i vendit largohet drejt Gjermanisë, SHBA dhe Kanadasë", vihet në dukje në këtë dokument të Ministrisë së re të Diasporës.

Në Shqipëri nuk ka shifra të sakta zyrtare lidhur me numrin e akademikëve, specialistëve, elitës intelektuale që është larguar për të jetuar dhe punuar në Perëndim. Dy destinacionet e preferuara SHBA dhe Kanadaja përtej Atlantikut e kanë futur në sistem marrjen e trurit përmes lotarive të përvitshme. Ndërsa në Gjermani po shkojnë të jetojnë dhe punojnë në mënyrë të ligjshme mjekë dhe infermierë të kualifikuar, pasi për ta ka nevojë. Shifrat e përafërta bëjnë fjalë për largimin e 1/3 së popullsisë së Shqipërisë.

### PASOJA TË RËNDA PËR SHQIPËRINË

Largimi i ajkës së intelektualëve dhe sidomos e rinisë ka pasoja të rënda: Shqipërisë i ikën pjesa më e mirë e kapitalit njerëzor, lokomotiva e zhvillimit të saj ekonomik dhe social. Ikja e rinisë po tkurr aktivitetin dhe efektivitetin prodhues në sektorin privat dhe po ngadalëson ritmet e procesit të afrimit të Shqipërisë me BE, proces i vlerësuar si katalizator i emancipimit shoqëror, zbatimit të ligjit dhe i kryerjes së reformave të mëdha.

"Mendo rininë që jeton në qytete të vogla... ku nuk ndodh asgjë dhe ku nuk ka punë, çfarë mund të bëjnë përveç se të kërkojnë të largohen?", - thotë Orest Çipa.

"E di që ikja e njerëzve të arsimuar nga Shqipëria do të ketë një kosto të jashtëzakonshme në progresin ekonomik dhe social të vendit. Por kur mungojnë kushtet për të zhvilluar karrierën dhe ndjekur vokacionin tënd, i çfarëdo lloji qoftë ai, nuk të mbetet gjë tjetër vetëm të largohesh. Mendo rininë që jeton në qytete të vogla Kavajë, Tepelenë, Himarë, Laç, etj., ku nuk ndodh asgjë dhe ku nuk ka punë, çfarë mund të bëjnë përveç se të kërkojnë të largohen?", thotë Orest Çipa.

### STRATEGJI PËR 'BRAIN GAIN', PËR TË FITUAR DHE MBAJTUR "TRURIN" NË SHQIPËRI

Që të kërkosh të realizohesh si individ, të aspirosh një jetë më të mirë, është një nga të drejtat themelore të njeriut, kur kjo ndodh pa thyer ligje dhe rregulla të vendeve pritëse. Qeveria "Rama 2" në hartimin e Strategjisë Kombëtare për të ndalur fenomenin e 'Brain Drain' dhe kthyer atë në 'Brain Gain' ka vendosur nxitjen dhe promovimin e emigracionit të përkohshëm dhe atij qarkullues për individë të kualifikuar dhe talentuar. Këtij qëllimi do t'i shërbejnë marrëveshjet me SHBA dhe Kanadanë për nxitjen e kthimit vullnetar në Shqipëri të emigrantëve të kualifikuar. Atyre do t'u jepet mundësia të vijnë në Shqipëri dhe qëndruar pak kohë për konsultime, dhënie leksionesh, trajnime, gjë që do të bëjë të mundur njëherazi regjistrimin e të gjitha kapaciteteve intelektuale jashtë vendit. Ndërsa të rinjve dhe të rejave të talentuar do t'u ofrohen bursa për të studiuar jashtë vendit dhe vende pune, kur të mbarojnë studimet.

## HOROSKOPI

### DASHI

Parashikohen ndryshime. Për momentin, mos merrni vendime të prera, që mund të mos jenë më pas të duhurat. Prisni sa të qartësohen gjërat. Mos bini pre e tundimit për të reaguar menjëherë, sidomos në punë. Rrezikoheni nga shpërqendrimet.

### DEMI

Të besoni më shumë te vetja do t'ju ndihmojë të arrini rezultate edhe më domethënëse, qoftë në lidhje me punët e juaja, qoftë në lidhje me njerëzit. E dini mirë se njerëzit nuk gjykohen nga paraqitja, por me një prezantim të mirë do të jeni vërtet në formën tuaj më të mirë!

### BINJAKET

Muaji ka nisur mirë dhe planetët do t'ju mbështesin që gjërat të shkojnë mirë. Me forcën tuaj të vullnetit do të arrini objektivat që i keni vënë vetes. Sharmi i juaj do t'ju ndihmojë të keni sukses edhe në shoqëri, ku prania juaj është shumë e kërkuar!

### GAFORJA

Mundësi për zhvendosje edhe të shkurtra nuk do t'ju vënë përpara vështirësive, por do t'u japin ngjyra aventurash të reja gjithçkaje që do të realizoni. Ju nuk duhet të bëni gjë tjetër veçse të ndiqni rrymën, duke mos u kthyer mbrapsht për asnjë arsye në botë.

### LUANI

Një mik i çmuar do t'ju lëshojë një kritikë. Do t'jua bëjë atë me mirëbesim dhe me shumë politesë, por gjithsesi do t'ju hidhërojë së tepërmi! Tregohuni të arsyeshëm... Lëreni pas të shkuarën, dhe jetoni përvoja të reja me entuziazëm të plotë.

### VIRGJERESHA

Në dashuri, falë Venusit ogurmirë, parapëlqeni qëndrueshmërinë sesa një aventurë të çastit, që do t'ju çonte ndoshta larg qetësisë. Do të keni një rizgjim të ndjenjave dhe pasioneve, që deri më tani i keni mbajtur të fshehta. E keni rrugën e lirë!

### PESHORJA

Mos i dëgjoni mendimet e trishta që ndonjëherë ju vijnë në kokë. Mos i mendoni. Heshtja do t'ju ndihmë me siguri të rivendosni ekuilibrin e brendshëm. Hëna ju do më pak të shëndoshë, kështu që shmangni ushqimet e yndyrshme.

### AKREPI

Mirëpriteni krahëhapur forcën pozitive të Jupiterit, që ju ndihmon të rinoheni dhe ta bëni jetën tuaj gjithmonë e më interesante dhe me më shumë avantazhe. Me Saturnin kundra, do të jetë mirë të kufizoni lëvizjet dhe të gjeni zgjidhje efikase për t'u qetësuar.

### SHIGJETARI

Do të menaxhoni çdo detyrë, duke zgjidhur edhe çështjet më të mërzitshme. Gjallëria juaj do t'ju ndihmojë të nisni një plan ekonomik shumë fitimprurës. Mos e kërkoni në vend tjetër atë që mund të jetoni ende me partnerin: angazhohuni për një bashkëbisedim të hollësishëm.

### BRICJAPI

Nuk mund të mohoni më faktet. Duke parë që një ngjarje e vjetër shfaqet vazhdimisht, më mirë të përballeni, njëherë e për gjithmonë, për ta lënë pas. Do të jeni të gatshëm dhe me humor të mirë. Do të shijoni anën e këndshme të dashurisë.

### UJORI

Qëndroni afër një bashkëpunëtori që ka zakon të flasë pak si shumë. Ka rrezik që të përhapë fjalë jo shumë të mira për ju. Mund t'i kërkoni këshillë kujt të doni, pos mos lejoni të ndikoheni për zgjedhje që kanë të bëjnë më fushën e dashurisë.

### PESHQIT

Dëshira për të përfituar nga mundësitë e mira të dhuruara nga Urani dhe Mërkuri, që bashkëveprojnë me Hënën do të shpërblehet. Jepini punës. Sot do të jeni në humor të mirë, do të keni dëshirë të qëndroni afër dhe të ndihmoni njerëzit.

Opinioni i Ditës

# Xhezair Zaganjori i vendos një gozhdë të fundit drejtësisë

Nga Ben Andoni

*(Vijon nga faqja e parë)*

... naiviteti i kreut të Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori, në një intervistë për "Gazetën Shqiptare". Mes shumë përgjigjeve, ajo që ka bërë përshtypje ka qenë qasja e tij me tagrin që mban si kreu i gjykatës më të rëndësishme të vendit.

Shfajësimi, në fakt, e ka fajësuar paq. Citojmë: "Ka pasur ndonjë rast që edhe mua më janë drejtuar politikanë të ndryshëm, të cilët në emër të personave të përfshirë në konflikte në zonat e tyre zgjedhore, etj., më kanë kërkuar përshpejtimin e gjykimit, zgjidhjen e konfliktit apo pezullimin e ndonjë vendimi penal. Jam përpjekur t'u shpjegoj se ata nuk mund të ndërhyjnë në çështje konkrete, qoftë si persona privatë apo funksionarë shtetërorë".

Në të gjithë intervistën nuk kanë bërë aspak përshtypje konstatimet e tij të tilla se: "Edhe pas gati 30 vjet ndryshimesh, ende politika përpiqet ta trajtojë gjyqësorin apo drejtësinë në përgjithësi, si oborrin e saj".

Ajo që njerëzit i ka shtangur ka qenë e thjeshtë dhe e thënë troç: Këtu ndërhyhet deri te 1-shi i Gjykatës së Lartë dhe nuk denoncohet. Pyetja e thjeshtë: po Juve jeni nga njerëzit më të fortë në Shqipëri sa i përket pushtetit gjyqësor, pse nuk e denonconi? Dhe sërish: nëse politikanët janë aq të paditur në rastin më të mirë që të ndërhyjnë direkt dhe aq të fortë në rastin më të keq, pse nuk i denonconi vallë?

Mjafton nxjerrja e tabulatit. E nuk mbaron këtu, sepse në shqyrtim mbetet dhe tagri i kryeprokurores së re. Në ligj, edhe vetë personi, që i është kërkuar të influencojë dhe nuk denoncon duhet të merret në cilësinë e personit, i cili ka dijeni për një vepër penale. Por, kjo nuk ndodh, ashtu si shumë e shumë gjëra të tjera në vendin tonë.

Prej gati katër vjetësh zoti Zaganjori është në krye të një institucioni që mund t'i jepte shumë fizionomi Shqipërisë, sa i përket reformës së saj në drejtësi me punën e tij, por edhe vullnetin e mirë për të ndryshuar. Por, ky institucion, në këto 27 vjet, duket se pret politikën që të bëjë hapin e parë.

Është i trishtë fakti se ku është katandisur drejtësia shqiptare dhe akoma më i trishtë mendimi sesi ndodh që persona me të tillë tagër nuk kanë fare vullnet ndryshimi.

Në fakt, akti i tij nuk çudit më askënd.

Të mjafton të shikosh performancën e institucionit të tij dhe të kuptosh se zgjidhjet e problematikave që shqiptarët i kërkojnë brenda "afatesh te arsyeshme", i marrin pas vitesh të tërë. Në një hulumtim që bëri pak javë më parë një media online në website-in e autoritetit gjyqësor më të lartë, Gjykatës së Lartë, konstatoi se problemet e qytetareve i nënshtrohen një pritjeje të stërgjatë dhe që nuk mund të konsiderohej aspak fare "e arsyeshme". Në më të shumën e herëve çështjet shumë shpesh shkonin deri në 3 vite pritje!!!

Kjo është fizionomia e institucionit të tij, që e ka aq të vështirë për të denoncuar politikanë, por që e ka aq të lehtë për të lënë në kalendar çështjet e qytetarëve të thjeshtë që rrinë e po shikojnë funeralin e drejtësisë shqiptare, një gozhdë të së cilës e ka vendosur dhe Zaganjori.

**www.gsh.al**

**Deputeti socialist duhet të dorëzojë mandatin në grupin e PS**

# Zgjedhjet në FSHF, Bashkim Fino shpall sot kandidaturën përballë Dukës

Ish-kryeministri Bashkim Fino pritet të shpallë sot kandidaturën për president të Federatës Shqiptare të Futbollit. Kështu, Fino ka vendosur të sfidojë Armando Dukën në zgjedhjet që do të zhvillohen në datë 7 shkurt. Për këtë garë ai duhet të dorëzojë edhe mandatin e deputetit që ka marrë në zgjedhjet e 25 qershorit. Por deri dje pasdite nuk ka dorëzuar gjë. Fino e ka gati platformën për të sfiduar Armando Dukën, i cili kërkon mandatin e pestë në krye të futbollit shqiptar. Pak kohë më parë Duka e Fino shkëmbyen replika publikisht. I pyetur gjatë një interviste për kandidimin e mundshëm të Bashkim Finos, Duka nuk e kurseu ironinë teksa u shpreh: "Nëse Bashkimi do të jetë kandidat për president si përfaqësues i Partisë Socialiste, ai duhet të dalë nga zyrat e saj. Nëse jo, partia duhet të bëjë të kundërtën dhe të thotë se distancohet nga kjo iniciativë që është e drejta e plotë e zotit Fino, e cila mund të jetë private. Partia Socialiste patjetër që do ta bëjë këtë gjë. Ose do ta vendosë si kandidatin e saj, ose do të thotë që është iniciativë private. Kjo do të jetë në të mirën e lojës që futbolli të mos jetë i varur nga politika". Pas kësaj ka pasur reagim edhe nga Bashkim Fino, i cili i ka kërkuar Armando Dukës të linte mënjanë sarkazmën, duke i kujtuar në të shkuarën mbështetjen e Partisë Socialiste.

Presidenti i Partizanit ka një peng, humbjen 5-0 në Gjirokastër dhe dështimin në këtë sezon

# Demi: Votojmë për platformën më të mirë për futbollin

## *Duka apo Fino? Të kuqtë të dyzuar*

Jeton Selimi

Gaz Demi nuk e ka kapërdirë dot humbjen poshtëruese në Gjirokastër! Presidenti i kuq, i intervistuar nga Top-Channel, rrëfen situatën që po kalon klubi i tij, por edhe ai vetë. Demi ndihet i tradhtuar nga skuadra dhe shuplaka e marrë nga Luftëtari i dhemb ende. "Në këto vitet e mia kjo është situata më e turpshme për Partizanin dhe më e vështirë. Megjithatë mendojmë sikur tani jemi futur në shina për të rikuperuar kohën e humbur. Ndeshja e Gjirokastrës është maskaradë, edhe sot kur e kujtoj nuk di çfarë të them. Nuk mund të them nëse ka pasur poshtërsi apo jo, se pa fakte nuk mund të flas. Për zërat që kam dëgjuar në ka vërtetësira, sot jemi në një kohë ku kontrollohet e verifikohet gjithçka. D.m.th. atë ditë is hte një skuadër pa karakter, sot kur e kujtoj më vjen turp", tha ai.

Drejtuesi më i lartë i Partizanit tregon se pret ende nga Federata Shqiptare e Futbollit titullin kampion që iu hoq Skënderbeut, por bën të qartë se nuk ka asnjë ambicie për të kandiduar, apo nuk mbështet ndonjë kandidat të veçantë në luftën për president të FSHF-së. Partizani dhe federata u përplasën sezonin e shkuar pas dënimit nonsens që të kuqtë morën në transfertën e Kukësit, ndërsa pas asaj përplasjeje, zyrtarisht, paqja nuk u rikthye kurrë mes palëve dhe prej asaj dite e në vijim, Partizani ka qenë zyrtarisht në opozitë me FSHF-në. Gjithsesi, presidenti Demi kërkon të mbajë një rol asnjanës, pavarësisht zërave që e shohin Partizanin si kundërshtar të kandidaturës së presidentit aktual të FSHF-së. Gjithashtu, Demi nuk lë pas dore as titullin e sezonit 2015-2016, që ende ka mbetur vakant pas vendimit të etikës. "Titulli nuk mund të rrijë në sirtarin e federatës. Duhet ta marrë vendi pasardhës. Aq më tepër që ne u përfaqësuam nga UEFA jo nga federata në Champions League. Presidenti? Ne si Partizan nuk kemi asnjë kandidaturë. Por do të shohim cilët do të jenë kandidatët dhe unë e kam thënë edhe herë të tjera, do të shoh dhe do të votoj për platformën më të mirë për futbollin shqiptar kushdo që të jetë, ky president që është apo ndonjë kandidat tjetër".

Demi zbulon se i kanë kërkuar që të kandidojë për postin e kreut të FSHF-së, por vetë presidenti i kuq tregon se nuk e ka me qejf diçka të tillë. "Më kanë thënë edhe më parë disa miq të mi që të kandidoja për president, dikur s'kisha lidhje me futbollin fare. Por nuk mund të kandidoj edhe pse kam shumë dëshirë të bëj gjëra të mira për vendin tim. Tani kam edhe konflikt interesi, pastaj edhe presidenti aktual është shumë i fortë vështirë të mundet", tha Demi.

**PRESIDENTI I LEGIAS**

## Mioduski: Sadiku luftëtar, por Edu na nevojitet më shumë

Armando Sadiku duhet të bëhet gati për një konkurrencë shumë më të fortë në pjesën e dytë të sezonit, nëse do të vazhdojë të mbetet pjesë e Legias së Varshavës. Afrimi i braziliani që ka luajtur për Kroacinë, Eduardo, nuk e ndihmon sulmuesin shqiptar, sidomos duke llogaritur se në klub shohin 35-vjeçarin si titullar në vazhdimin e sezonit. Presidenti i Legias së Varshavës, Dariusz Mioduski, ka konfirmuar në një intervistë se ka shpresa të mëdha se Eduardo mund të bëjë diferencën për klubin e tij dhe e sheh si një gjahtar goli që i mungonte skuadrës, praktikisht duke kaluar në plan të dytë Sadikun. "Eduardo do të ndihmojë Niezgoda, ai mund të mësojë shumë. Me të mund të luajmë me dy sulmues. Eduardo mund të na sjellë edhe tifozët në stadium. Na mungonte një gjahtar zone dhe erdhi këtu për tituj, është ende i uritur. Edhe nëse do të luajë me 50% të asaj që jepte 10 vite më parë, ai do të jetë një ndihmë e madhe për ne gjithsesi. Çfarë do të ndodhë me Sadikun? Gjithçka është e hapur. Por Sadiku dëshiron të luftojë për vendin e tij, ai nuk dorëzohet. Kjo më pëlqen",-ishin fjalët e presidentit të Legias së Varshavës.

**MESFUSHORI**

## Kaçe drejt Panathinaikosit, PAOK-u pranon ofertën

Me sa duket do të marrë fund në mënyrë pozitive për Ergys Kaçen telenovela e merkatos në këto ditë të para të janarit sa i përket transfermit të mesfushorit shqiptar të klubi i Panathinakos. I lënë në harresë te PAOK ku nuk ka hapësira aktivizimi për të, mesfushori është shumë pranë kalimit te një klub, i cili është shpallur 20 herë kampion në Greqi, por aktualisht po kalon një krizë financiare. Kaçe është pjesë e marrëveshjes mes dy klubeve për kalimin e Moludo nga Panathinaikos te PAOK. Mbrojtësi brazilian do të huazohet deri në fund të sezonit te PAOK dhe në këmbim Panathinaikos do të marrë 500 mijë euro, si dhe Kaçen e Konstandinidis. Lojtarët do të jenë në huazim deri në verë, me të drejtë blerjen e tyre përfundimtare. Kjo është zgjidhja ideale për mesfushorin shqiptar, i cili nuk luan rregullisht prej kohësh dhe është zhdukur nga fusha e lojës, edhe pse deri dy vite më parë cilësohej si një nga talentet më të mëdhenj të prodhuar nga kampionati grek në vitet e fundit.

## Reali synon Mohamed Salah, Liverpuli sheh nga Papu Gomez

Transferimi i Filip Kutinjos te Barcelona mund të sjellë lëvizje të tjera të mëdha në merkaton e klubeve në Europë. Liverpuli ka fonde të mjaftueshme për të investuar për afrimin e lojtarëve të rinj, ndërsa klubet e tjera duan të mbajnë hapin e katalanasve. Sipas mediave në Angli, Real Madrid është gati t'i kundërpërgjigjet lëvizjes së rivalëve historikë duke marrë edhe ai një lojtar nga Liverpuli. Bëhet fjalë për egjiptianin Mohamed Salah, i cili do të siguronte shpejtësinë që i mungon aktualisht skuadrës së Zidan. Kjo do të shtynte Liverpulin të investonte përsëri në merkato dhe skuadra e Klop ka hedhur sytë në Itali, një treg, i cili vitet e fundit ka pasur shkëmbime të shpeshta lojtarësh me Anglinë. Objektivi i "të kuqve" mendohet se është argjentinasi Papu Gomez, sulmuesi i Atalantës, i cili ka shfaqur një formë të shkëlqyer në dy sezonet e fundit duke fituar edhe ftesa nga përfaqësuesja e vendit të tij.

## Kukësi super, thyen edhe Bursasporin

Kukësi i Peter Pakult po shfaq në këto ditë të para të fazës përgatitore një fytyrë krejt tjetër nga skuadra e brishtë, e cila nën urdhrat e Milinkoviç zhgënjeu në pjesën e parë të sezonit. Ekipi verilindor, ka regjistruar sot fitoren e dytë në fazën përgatitore në Antalia, duke mundur me shifrat 2-1 me përmbysje skuadrën e Bursaspor. Kjo e fundit kishte mposhtur 3-0 Skënderbeun vetëm dy ditë më parë dhe dominoi plotësisht pjesën e parë të ndeshjes ndaj kampionëve në fuqi të Shqipërisë duke gjetur golin e avantazhit me një goditje dënimi të Bataja. Por në pjesën e dytë, skuadra shqiptare dhuroi një lojë krejtësisht ndryshe, duke sulmuar vazhdimisht në kërkim të golit dhe e gjeti atë pasi një harkim i Imamit nga krahu i djathtë përfundoi në rrjetë pa u prekur nga askush. Pak minuta më vonë, një kundërsulm i shpejtë i Shkodrës solli edhe golin e përmbysjes 2-1, rezultat që nuk do të ndryshonte deri në fund edhe pse të dy ekipet kishin raste të tjera për të shënuar.

# Fjalëkryqi (1)



37. Italia në Internet.
38. Fillojnë vonë.
39. Krijoi James Bond.
40. Ishulli i Odiseut.
42. Van der portier.
43. Një karamele aromatike.
44. Mund të shkojnë... nga frika.

VERTIKAL
1. Bëhet duke vënë në lojë.
2. Pak origjinale.
3. Thahet me bonifikim
4. Në fund djathtas.
5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
7. Hidhet një për shesh.
9. Kokëkuqja në pit stop.
10. I famshëm ai i Sizifit.
12. Eshtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
13. Një diktator shtypës
14. Lëvizja Socialiste Spanjole.

VERTIKAL
1. Të çara ato të Shollohov.
5. Fillojë luftën.
6. Liszt kompozitor.
8. Marsi në Areopag.
9. Kështu fillon filmi.
11. Gjysmë linear.
12. Një freskues në tavan.
18. Eshtë gazeta Panorama.
20. Mund të jenë kamikaze.
21. Masat pa kufij
23. Venier e spektaklit italian.
25. Sophia e kinemasë.
26. Safin tenist.
29. Eshtë makut, i pangopur.
31. Eshtë faqe ene.
32. Një kafshë që hap... galeri.
33. Një fytyrë e keqe.
35. Preken nga sindroma Basedow.
15. I kanë çift radhët.
16. Janë llahtare.
17. Poeti kur nuk pi.
19. Fillojnë periudhën.
22. Omar që qe aktor.
24. Si sezonale.
25. Janë banorët në Riga.
26. Carey këngëtare.
27. Nuk i tregohen babait.
28. Bëjnë arte me re.
29. Kush ka... e ka humbur toruan.
30. Një stacion orbital.
31. Fillojnë profesionin.
33. Gibernau i MotoGp.
34. I kanë të ndryshme tutat
36. Gjysmë ditari.
38. Varet me re.
41. Kufijtë e kujtesës.
42. Sapo fillonjë.

# Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Gustav kompozitor.
6. Në krye të kryesisë.
7. Lexohet në pentagram.
11. Sastre aktore.
12. Gjysmë akordi.
15. Dhjetë angleze.
16. Satira që zë.
18. Eshtë situata e tensionuar.
21. Pak teatrale.
22. Bëhet me mea culpa.
24. Fundi i një samurai.
25. Mbeten në fund.
26. Lind në kokë.
28. Në radhë të parë.
29. Inicialet e Camus
30. Një verë në Paris.
31. Partizani i vogël... në një film tonin.
33. Litra pa kufij.
35. Eshtë fatë.
36. Një pjesë e kinematografisë.
37. Një pjesë e akademisë.
39. Kufijtë e tretjes.
40. Mbyll të çarën.
41. Erik çiklist.
43. Një pjesë e medaljes.
44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës
51. Mbyllin një spital.
52. Mbyllet me dorezë.
53. Ishin kalorësit si Rolandi
54. Ndal në... kryqëzim.



VERTIKAL
1. Janë enigmatikë.
2. Mund të jenë parabolike.
3. Ishte xhelozja e Olimpit.
4. Kufijtë e lëvizjes.
5. Fillojnë radhitjen.
6. Janë kushte.
8. Totem pa ekstreme.
9. Mbyllin kanate.
10. Shoqëronte Edipin e verbër.
13. Eshtë gjeli.
14. Moore aktore.
17. Janë forcat e Reneas.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin dritaren.
26. Fillojnë matjet.
27. Duhen ruajtur.
32. I bën një serenatë Rosina-s.
34. Gjysmë rabini
38. Mustafa.. Ataturk.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Ai i muzave është Helikona.
45. Një pjesë e gadishullit
47. Muzika e Eminem.
49. Fillojnë operacionin.
50. Kapen të parat.
52. Kufijtë e drejtëzës.

# Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | | 1 | | 9 | | 4 | | 2 |
| | 7 | | | | | | 3 | |
| | 6 | | 4 | | 7 | | 8 | |
| 2 | | | | 1 | | | | 3 |
| | | | 9 | | 6 | | | |
| 3 | | | | 7 | | | | 8 |
| | 2 | | 1 | | 5 | | 9 | |
| | 3 | | | | | | 1 | |
| 8 | | 5 | | 6 | | 7 | | 4 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 5 | 2 | **9** | **8** | 3 | **4** | 6 | 7 |
| **6** | 8 | 9 | **7** | 4 | 1 | **5** | 2 | **3** |
| **4** | **3** | **7** | 6 | 2 | 5 | 8 | **1** | 9 |
| 2 | **4** | **5** | **8** | **3** | 7 | 6 | **9** | 1 |
| 8 | 9 | **1** | **5** | 6 | **2** | **7** | 3 | 4 |
| 7 | **6** | 3 | 1 | **9** | **4** | **2** | **8** | 5 |
| 3 | **1** | 6 | 4 | 5 | 8 | **9** | **7** | **2** |
| **5** | 2 | **8** | 3 | 7 | **9** | 1 | 4 | **6** |
| 9 | 7 | **4** | 2 | **1** | **6** | 3 | 5 | 8 |

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| H | E | S | A | P | E | T | ■ | T | P | ■ | A | B | C |
| E | M | I | R | A | T | E | ■ | A | R | A | B | E | T |
| L | I | K | E | R | ■ | B | E | T | O | N | E | T | ■ |
| E | L | ■ | S | A | D | ■ | R | I | V | A | L | E | T |
| N | ■ | R | ■ | B | U | R | I | M | E | T | ■ | J | A |
| ■ | M | A | R | O | K | E | N | E | ■ | O | D | A | T |
| ■ | F | U | L | L | A | N | I | ■ | E | M | E | ■ | A |
| P | ■ | L | ■ | A | ■ | A | T | O | M | I | K | E | ■ |
| A | N | ■ | S | T | E | R | E | O | ■ | ■ | O | L | T |
| P | A | R | ■ | ■ | S | D | ■ | ■ | M | A | R | I | A |
| A | N | A | N | I | A | ■ | P | R | E | S | I | O | N |
| S | A | R | D | O | U | ■ | D | E | T | I | ■ | T | A |

FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P | A | R | A | G | R | A | F | I | ■ | I | V | A | N |
| I | R | O | N | I | A | ■ | ■ | O | S | ■ | E | R | A |
| R | A | B | A | T | ■ | B | A | N | ■ | A | R | A | ■ |
| A | M | E | ■ | ■ | T | A | N | ■ | V | R | I | M | A |
| T | I | R | ■ | T | E | L | E | M | A | K | U | ■ | L |
| ■ | S | ■ | P | O | L | E | M | I | K | A | ■ | E | L |
| V | ■ | K | A | N | A | R | I | N | A | ■ | E | N | A |
| A | L | ■ | V | A | T | I | K | A | N | I | ■ | E | N |
| J | O | E | ■ | T | ■ | N | E | ■ | T | E | M | A | ■ |
| R | I | M | A | ■ | R | A | ■ | D | E | T | I | ■ | A |
| A | R | I | A | N | A | ■ | A | R | ■ | U | N | I | K |
| T | A | L | E | N | T | ■ | M | A | U | R | I | C | E |

# Argëtim filozofik

DA VINÇI

- Të jesh me karakter do të thotë, të jesh i drejtë edhe kur s'të sheh njeri.
- Kur ti të fitosh, unë me krenari do i them botës: "Ky është miku im". Por kur të humbasësh, unë do të jem pranë teje duke të shtrënguar dorën dhe të të them: "Unë jam miku yt."
- Jeta është si një libër, varet si e shkruan dhe me çfarë boje...

## KRIPTOSKEMË



## KRIPTOSKEMË

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | C | R | ■ | A | L | K | I | M | I | S | T | I |
| C | O | S | T | N | E | R | ■ | ■ | P | ■ | A | V |
| I | L | ■ | R | ■ | M | ■ | I | I | ■ | K | L | A |
| R | ■ | K | O | P | E | R | N | I | K | U | ■ | N |
| K | O | O | P | E | R | A | T | I | V | A | T | ■ |
| ■ | K | L | I | N | I | K | E | ■ | ■ | L | ■ | F |
| T | R | O | K | E | ■ | I | R | O | N | I | K | E |
| R | ■ | S | A | L | T | ■ | E | V | I | T | A | ■ |
| I | T | A | L | I | A | ■ | S | E | ■ | E | V | A |
| U | ■ | L | E | ■ | ■ | M | A | R | ■ | T | A | C |
| M | A | E | ■ | J | E | A | N | ■ | L | I | J | A |
| F | U | T | U | R | I | S | T | E | T | ■ | A | R |

# Thënie të mençura

- Kur i drejtoheni forcës, një gjë nuk duhet t'a bëni kurrë: të humbisni. **(Duajt Ajzenhauer)**
- Një njeri i guximshëm arrin të jetë mazhorancë. **(Endrju Xhekson)**
- Prej njëqind sëmundjeve, pesëdhjetë shkaktohen nga gabimet tona e pesëdhjetë të tjera nga mosdija jonë.
- Irlandeze: Ji i lumtur me çfarë ke, do të shohësh se ke përse të jesh i lumtur.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!